



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Matematikë”**

ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Partizan Malkaj

2. Prof. Asoc. Dr. Lekë Pepkolaj

Tetor 2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për programin e studimit Master i Shkencave në “Matematikë” ofruar nga Universiteti i
Tiranës

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Matematikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Matematikë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1272, datë 17.09.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 168, datë 13.06.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Nuk ka
8	Cikli i studimit:	Kohë e plotë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite/4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Nuk ka
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Nuk ka
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	2023-2024: 15 PAE dhe 3 PAK 2022-2023: 15 PAE dhe 3 PAK 2021-2022: 15 PAE dhe 3 PAK
18	Numri i studentëve:	2024- 2025: 15 studentë 2023-2024: 12 studentë 2022-2023: 10 studentë 2021-2022: 11 studente
19	Komente /të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës është një Institucion publik i arsimit të lartë, më i vjetri dhe më i madhi në vendin tonë dhe i krijuar në vitin 1957. Institucioni është riakredituar për herë të dytë me vendim nr. 04 datë 27.01.2023 me kohëzgjatje maksimale prej 6 vite akademike, afati i vlefshmërisë është deri me 26.01.2029. Universiteti i Tiranës përbëhet nga 6 Fakultete dhe 2 Institute. Fakulteti i Shkencave të Natyrës përbëhet nga 8 departamente ku përfshihet edhe Departamenti i Matematikës dhe Qendra Kërkimore e Florës dhe Faunës.

Departamenti i Matematikës është krijuar në vitin 2014 me vendim Senati të UT, nr. 38 datë 22.01.2014 dhe ka katër programe studimi. Programi i studimit Master i Shkencave në “Matematikë” përfshihet në ciklin e dytë të studimeve universitare të ofruara prej Departamentit të Matematikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Ky program studimi akreditohet për herë të parë bazuar në kërkesën e Rektorit të Universitetit të Tiranës për aplikim për akreditimin e programeve të studimit drejtuar ASCAL-it, me shkresën e datës 24.05.2023, Nr. 462/1 Prot.

Ky program studimi ofrohet me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike dhe është organizuar në bazë të sistemit European të Transferimit të Krediteve në 120 kredite ECTS, ku në përfundim të tij përfitohet Diplomë Universitare Master i Shkencave në “Matematikë”. Programi i studimit Master i Shkencave në “Matematikë” është i hartuar dhe zbatohet nga Departamenti i Matematikës duke harmonizuar të gjithë komponentët e tij në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe me qëllimet dhe misionin e Institucionit dhe Departamentit. Qëllimi i këtij programi studimi është: Të ofrojë një formim të thelluar në disiplinat kryesore të matematikës teorike dhe të aplikuar. Të zhvillojë aftësitë e studentëve për të përdorur programe bashkëkohore dhe metoda të avancuara kërkimore në fusha të ndryshme shkencore dhe profesionale. T’i përgatisë studentët për t’u përfshirë në mësimdhënie, kërkim shkencor, si dhe në sektorët ekonomikë dhe institucionalë ku matematika ka rol të rëndësishëm. Të sigurojë që studentët të jenë gjithmonë të përditësuar me zhvillimet e reja teknologjike dhe kërkesat e tregut në ndryshim të vazhdueshëm.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në Maj 2025. Ky Raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti i Tiranës për të përmbushur objektivat e tij si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti i Tiranës, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër evidencash mbështetëse.

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë përzgjedhur duke patur në konsideratë kompetencat profesionale në lidhje me fushën e matematikës ku ofrohet ky program studimi, eksperiencia e tyre në vlerësime të programeve të studimit, integriteti profesional, mungesa e konfliktit të interesit për të siguruar paanshmëri dhe objektivitet në gjykim dhe në vlerësim.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe VKM 185, datë 25.3.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” të ndryshuar.

GVJ gjatë vlerësimit të jashtëm u mbështet nga specialisti i ASCAL, Msc. Aviola Bardhi. Takimet në institucion, u zhvilluan në dy ditë sipas programit të miratuar nga ASCAL në datat 22.05.2025 dhe 23.05.2025. Nga ana e Departamentit të Matematikës dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës ishin marrë të gjitha masat për realizimin me sukses të vizitës. Takimet konsistuan në zhvillimin e diskutimeve, me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Drejtuesin e Departamentit të Matematikës, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, personelin akademik, studentët, Degën e procesit mësimor, Degën e Projekteve dhe Sigurimit të Cilësisë, Degën e Burimeve Njerëzore dhe Informacionit dhe Specialistë të Këshillimit të Karrierës, si dhe përfaqësues të sekretarisë mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë.

Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të nxënit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj.

Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Më datë 13.10.2025, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 162/28 Prot., datë 14.10.2025, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti i Tiranës kthehu përgjigje në sistemin AMS më datë 22.10.2025.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Matematikë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Matematikë”, i ofruar nga Departamenti i Matematikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, është konceptuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe dokumenteve strategjike kombëtare. Ai reflekton dispozitat e Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, respekton Statutin e Universitetit të Tiranës dhe mbështet objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2018–2023. Këto dokumente përcaktojnë qartë detyrimin për të ofruar programe që nxisin cilësinë akademike, qëndrueshmërinë shkencore dhe orientimin drejt zhvillimeve shoqërore. Nëpërmjet përmbajtjes dhe strukturës së tij, programi i kontribuon konsolidimit të vlerave akademike dhe të trashëgimisë kulturore, pa cenuar interesat kombëtare. Ai synon të përgatisë studentë me formim të thelluar teorik dhe me kompetenca të avancuara në matematikë, të cilët janë të pajisur për të ndjekur karriera në kërkimin shkencor dhe në mësimdhënie, por edhe për të zbatuar njohuritë e fituara në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe teknologjisë. Kjo qasje, e mbështetur në përmbajtje akademike bashkëkohore dhe metodologji të orientuara drejt zgjidhjes së problemeve reale, rrit punësimin e studentëve dhe fuqizon kontributin e tyre në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të vendit. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.2 Strategjia e Zhvillimit UT] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit]
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Matematikë” është zhvilluar në përputhje me misionin dhe vizionin afatgjatë të Universitetit të Tiranës, të përcaktuara në statutin e tij. Përmbajtja akademike dhe struktura organizative e programit janë ndërtuar në mënyrë që të përgatisin profesionistë me profil të fortë shkencor dhe kërkimor, në përputhje me ndryshimet shoqërore dhe zhvillimet teknologjike bashkëkohore. Statuti i Universitetit thekson rëndësinë e ofrimit të cikleve të plota të studimeve – nga niveli bachelor deri te doktoratura – dhe të kontributit të arsimit të lartë publik në shërbim të zhvillimit të shoqërisë, përmes kërkimit shkencor. Në këtë kuadër, programi në fjalë operon si zbatim konkret i këtyre parimeve, duke ofruar

	një formim të thelluar në matematikë të pastër dhe të aplikuar, me qëllim përgatitjen e studentëve për sfida kërkimore, mësimore dhe profesionale në sektorë të ndryshëm. Misioni i programit është plotësisht i harmonizuar me objektivat strategjike të institucionit: ai promovon avancimin e dijes shkencore përmes një lidhjeje të balancuar midis teorisë dhe praktikës kërkimore, duke synuar që këto njohuri të jenë të dobishme për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në nivel kombëtar dhe rajonal. Kjo qasje e bën programin një komponent të rëndësishëm në realizimin e misionit institucional në mënyrë të prekshme dhe efektive. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Matematikës] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit]
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Institucionit.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Matematikë” është ndërtuar mbi bazën e dokumenteve themelore të Universitetit të Tiranës, përkatësisht Statutit, Rregullores dhe Strategjisë për Zhvillim. Hartimi dhe ofrimi i tij mbështeten në një analizë koherente të këtyre dokumenteve, duke siguruar që përmbajtja akademike dhe objektivat e programit të jenë të sinkronizuara me drejtimet institucionale. Statuti i Universitetit të Tiranës përcakton qartë se misioni i institucionit është të ofrojë një gamë të gjerë programesh në të gjitha ciklet e studimeve – bachelor, master dhe doktoratë – si dhe të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë përmes arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe shërbimeve publike. Në këtë kontekst, programi në fjalë jo vetëm që është i përputhur me këtë mision, por edhe konkretizon funksionin e tij përmes zhvillimit të një profili akademik të orientuar drejt aftësisë profesionale dhe kërkimit shkencor me ndikim rajonal e kombëtar. Përveç përmbushjes së kriterëve formale, programi kontribuon drejtpërdrejt në ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave akademike dhe kulturore të përmendura në Statut, duke shërbyer si urë lidhëse midis qëllimeve strategjike dhe veprimtarisë konkrete institucionale. Përmbajtja dhe struktura e programit janë projektuar në mënyrë që të përputhen me drejtimet akademike të UT, duke siguruar integritet të brendshëm institucional dhe zbatim të qëndrueshëm të objektiveve të dokumenteve rregullative dhe strategjike. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.2 Strategjia e Zhvillimit UT] [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit]
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në	Dokumentet themeltare të Universitetit të Tiranës, përfshirë statutin dhe strategjinë e zhvillimit, përcaktojnë qartë rolin që institucionet e arsimit të lartë duhet të luajnë në zhvillimin ekonomik, social dhe teknologjik të vendit. Ky orientim institucional bazohet në formimin e specialistëve të kualifikuar dhe në promovimin e kërkimit shkencor si mjete për adresimin e nevojave të shoqërisë dhe të tregut të punës. Në këtë linjë, programi Master i Shkencave në “Matematikë” është projektuar për të përgatitur

dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	profesionistë me kompetenca të thelluara në matematikë, të aftë për të kontribuar në inovacion dhe zhvillim në kontekste të ndryshme ekonomike dhe teknologjike. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.2 Strategjia e Zhvillimit UT] [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 5.16 Studimi i Tregut të Punës UT FSHN]			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e dokumentacionit dhe përmbajtjen e programit të studimit "Master i Shkencave në Matematikë", rezulton se standardi përmbushet plotësisht. Programi është hartuar në përputhje të qartë me misionin, vizionin dhe strategjitë e zhvillimit të Universitetit të Tiranës, duke reflektuar kërkesat e kuadrit ligjor dhe dokumenteve rregullative kombëtare. Ai përputhet me interesat kombëtare dhe kontribuon në ruajtjen e vlerave akademike dhe kulturore, në përgatitjen e profesionistëve të aftë në fushën e matematikës, si dhe në zhvillimin kërkimor dhe teknologjik të vendit. Programi demonstroi kohëzotim të brendshme me fushat akademike të institucionit dhe përfaqësim me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe kërkimit shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti i Tiranës, përmes Departamentit të Matematikës, ka ndërtuar ndër vite një profil të qëndrueshëm akademik dhe kërkimor në fushën e matematikës, çka pasqyrohet në strukturën e qëndrueshme të personelit, historikun e programeve të ofruara dhe nivelin e angazhimit shkencor të stafit. Përbërja aktuale e stafit akademike, që përfshin 15 pedagogë me kohë të plotë – nga të cilët 3 janë Profesor Doktor, 7 janë Profesorë të asociuar, 5 mbajnë gradë Doktor – tregon një diversitet kualifikimesh dhe një balancë të nevojshme ndërmjet përvojës akademike dhe potencialit për zhvillim të mëtejshëm. [Evidenca 1.7 Personeli akademik i Departamentit të Matematikës dhe kualifikimi i tij] [Evidenca 2.12 Lista e stafit akademik DM] [Evidenca 2.13 CV shqip dhe anglisht Programi Master] [Tabelat ASCAL] Ky konfigurim siguron mbështetje efektive për realizimin e objektivave formues të programit, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë aplikativ. Përveç kapaciteteve njerëzore, infrastruktura institucionale e Universitetit

	të Tiranës ofron një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe kërkimore. Hapësirat në dispozicion – që përfshijnë një truall me sipërfaqe 190,597 m², me sipërfaqe godinash 19835 m² dhe 48888 m² sipërfaqe të shfrytëzueshme ndërtimi – krijojnë mundësi reale për organizimin e procesit mësimor në kushte të përshtatshme. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, konkretisht, e zhvillon aktivitetin në katër godina (A, B, C dhe D), të cilat përmbajnë salla mësimi me kapacitete të ndryshme dhe ambiente të përshtatshme për leksione dhe seminare. Megjithatë jo të gjitha sallat janë të pajisura me infrastrukturë teknologjike moderne (p.sh. video projektorë), kushtet aktuale mundësojnë zhvillimin e mësimdhënies në nivele të pranueshme. Për më tepër, në funksion të formimit praktik të studentëve, Departamenti ka në përdorim një laborator të dedikuar të informatikës, i cili përbën një komponent të rëndësishëm në përvetësimin e njohurive aplikative, veçanërisht në ndërthurjen e matematikës me teknologjinë. [Evidenca 1.2 Strategjia e Zhvillimit UT] [Tabela 16 ASCAL] [Evidenca 4.10 Lista e Ambienteve të Departamentit] [Evidenca 4.11 Foto të laboratorit të Matematikës] [Evidenca 4.12 Foto të pajisjeve audio vizive të departamentit] [Evidenca 4.13 Infrastruktura, kapacitete FSHN]
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në Matematikë është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit me udhëzimet kombëtare e evropiane. Ky program studimi zhvillohet në gjuhën shqipe, i përket Kornizës 7 të Kualifikimeve Shqiptare, 2 vite akademike, 120 kredite në total, është i nivelit Master dhe realizohet në gjuhën shqipe. Kodi i programit të studimit është 72MS0541S dhe ai është në përputhje të plotë me fushën specifike të këtij programi studimi. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.2 Strategjia e Zhvillimit UT] [Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Matematikës] [Evidenca 1.5 Plani i zhvillimit strategjik të programit të studimit Msc në Matematikë] [Evidenca 2.5 Plani mësimor, Diplomë e studimeve të Ciklit II(DND) në Matematikë 2008-2009]
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master i Shkencave në Matematikë është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Departamentit të Matematikës. Departamenti i Matematikës nuk ofron programe ndërdisiplinore. [Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Matematikës] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programit të Studimit]

ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi		
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Institucioni në bashkëpunim me FSHN ka rreth 70 marrëveshje bashkëpunimi, të cilat ofrojnë trajnime për studentët e diplomuar. Ja vlen të theksohen marrëveshjet me Insubria Universita, Bashkia Tiranë, Universiteti i Prishtinës. Këto marrëveshje konsistojnë në intershipe, projekte të përbashkëta, organizime konferencash. [Evidenca 1.8 Marreveshjet e FSHN] [Evidenca 1.9 Marreveshjet me UT] [Tabela 5 ASCAL] [Evidenca 3.33 Marreveshje dypaleshe FSHN- KOSOVA] [Evidenca 3.34 Marrveshje dypaleshe me INSUBRIA UNIVERSITA]		
Konkluzione	<i>Programi “Master i Shkencave në Matematikë” është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë përgjegjëse. Universiteti i Tiranës, përmes Departamentit të Matematikës, garanton përvojë, staf të kualifikuar dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e programit. Programi ndjek strukturën dhe nivelin e kërkuar sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, ndërsa procesi i kodifikimit është ende në proces. Gjithashtu, janë në fuqi marrëveshje bashkëpunimi që mbështesin trajnime dhe zhvillim profesional për studentët e diplomuar.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes	Departamenti i Matematikës ka një bashkëpunim të ngushtë me departamentet e tjera të FSHN si Departamentet e Matematikës së Aplikuar, Fizikës, Informatikës. UT, FSHN, Dega mësimore në bashkëpunim me Departamentet koordinojnë ngarkesën e personelit akademik dhe procesin mësimor. Marrëdhëniet mes njësisë sigurohen nga zbatimi i Statutit dhe rregullores së UT. Në analizën vjetore të Fakultetit

së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	gjendet analiza e vazhdueshme e punës qe del nga bashkëpunimet e cituara më sipër. Detyrat e stafit janë të përcaktuara qartë në rregulloret përkatëse të departamentit, si dhe të njësive administrative në shërbim dhe në ndihmë të realizimit të programit të studimit. Gjithashtu në shërbim të programit të studimit janë edhe kujdestarët akademik nga një për studentët e çdo viti (viti I dhe viti II). [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Matematikës] [Evidenca 2.15 Lista e kujdestareve per studentet e cdo viti Programit Master Shkencor ne Matematike] [Evidenca 3.24 Raport mbi analizen vjetore te Departamentit te Matematikes 2021-2022]
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Për realizimin me sukses të procesit të mësimdhënies- nxënies, UT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me 100 universitete homologe jashtë vendit (2015-vazhdim) dhe për periudhën 2019-2023 ka nënshkruar mbi 50 marrëveshje në kuadër të programit Erasmus+KA107, të listuara në faqen zyrtare të Universitetit të Tiranës. Në kuadër të tyre kanë përfutuar bursa Erasmus+ 2 pedagog të këtij programi studimi. [Evidenca 1.8 Marreveshjet e FSHN] [Evidenca 1.9 Marreveshjet me UT] [Evidenca 2.28 Lista e mobiliteteve dhe pjesemarrje ne cost] Departamenti i Matematikës është përfshirë në projektet: - “Sfida e kurrikulës së re të Matematikës në arsimin universitar dhe ndikimi i saj në sistemin parauniversitar”. - “Roli i laboratorit didaktik-informatik-kërkimor në pëmirësimin e kërkimit shkencor në lidhje me mësimdhënien e matematikës” AKKSHI. - “Ndikimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit në mësimdhënien e mësimnxënien e matematikës pë arsimin e mesëm shqiptar” PKKZH. Workshopi “Sfida e kurrikulës së re të Matematikës në arsimin universitar dhe ndikimi i saj në sistemin parauniversitar”. Organizmi i shkollës verore CIMPA. [Evidenca 3.6 CIMPA] [Evidenca 3.7 Projekt i financuar nga FSHN] [Evidenca 3.8 Workshop i organizuar nga Departamenti i Matematikes FSHN] [Evidenca 3.9 Projekti PKKZH] [Evidenca 3.10 Projekti PIKSH]
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore,	FSHN falë bashkëpunimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar u ofron studentëve trajnime, internship-e dhe mobilitete për realizimin praktikave profesionale dhe kërkimit shkencor. Departamenti i Matematikës ka përfshirë studentët në konferencën shkencore me rastin e 65 vjetorit të Universitetit të Tiranës dhe në konferencën ‘Western Balkan Conference

kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	on Mathematics and Application' Kosovë. Për programin e studimit nuk ka mobilitete nga stafi apo studentët në kuadër të programit Erasmus+. <i>Praktika profesionale nuk është e përfshirë në programin e studimit.</i> [Evidenca 1.8 Marreveshjet e FSHN] [Evidenca 1.9 Marreveshjet me UT] [Evidenca 3.33 Marreveshje dypaleshe FSHN- KOSOVA] [Evidenca 3.34 Marrveshje dypaleshe me INSUBRIA UNIVERSITA] [Evidenca 3.36 Regjistri themeltar të studentëve] [Evidenca 5.5 Aktivitete me dhe per studentet]		
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	FSHN dhe Departamenti i Matematikës kanë hartuar raporte vjetore të veprimtarive të njësive dhe këto raporte përfshijnë edhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Këto raporte ndahen me instancat e tjera DSBC, zyra Alumni, studentët. [Evidenca 3.24 Raport mbi analizen vjetore te Departamentit te Matematikes 2021-2022] [Evidenca 3.25 Raportet 22-23] [Evidenca 3.26 Shkresa e Raporti vjetor 2022-2023] [Evidenca 3.27 RAPORTI VJETOR FSHN UT 2023-2024]		
Konkluzione	<i>Universiteti i Tiranës, përmes Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Departamentit të Matematikës, ka vendosur marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me institucione të brendshme dhe të huaja, që mbështesin procesin mësimor dhe kërkimin shkencor. Ekziston bashkëpunim ndërdepartamental për mbarëvajtjen e programit dhe pjesëmarrje në projekte kërkimore relevante. Janë nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare (p.sh. Erasmus+), megjithatë, mobiliteti i stafit dhe studentëve për programin përkatës mbetet i kufizuar, dhe praktika profesionale nuk është pjesë e programit të studimit. Raportet analitike mbi bashkëpunimet hartohen dhe shpërndahen rregullisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master i Shkencave Matematikë është i organizuar në lëndë dhe sipas legjislacionit në fuqi. Studimet organizohen me kohë të plotë dhe i përkasin nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Çdo lëndë karakterizohet nga: tipologjia A (13 kredite), B (60 kredite), C (12 kredite), D (5 kredite), dhe E (30 kredite), numri i krediteve sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), si dhe shpërndarja kredite/orë në leksione/seminare/laboratore. <i>Detyrimet përmbyllëse, tipologjia E duhet të jenë nga 12-18 kredite dhe janë 30 kredite. Lëndet plotësuese, tipologjia D duhet të jenë 12 kredite dhe janë 5 kredite.</i> Programi i studimi ka një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike për një total prej 120 ECTS. Kreditet shpërndahen në mënyrë të barabartë mes semestrave, 60 ECTS për çdo vit. Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet me mbrojtje diplome. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht]
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit, për nga vetë objektivat e tij, ka si qëllim dhënien e njohurive të avancuara në fushën e matematikës teorike, duke synuar formimin e profesionistëve me kompetenca të thelluara në këtë fushë. Në semestrin e parë, në program trajtohen lëndë të përgjithshme në nivel të avancuar për të përforcuar njohuritë e themelore të programit në lëndë si p.sh.: “Topologji dhe integrim”, “Ekuacione diferenciale”, “Algjebër”, etj. Pas një panoramike gjithëpërfshirëse, në semestrin e dytë studentët njihen me lëndë specifike si “Probabilitet dhe statistikë”, “Gjeometri” “Analizë hilbertiane”, etj. Në semestrin e tretë, studentët ndjekin lëndët “Grupet topologjike” “Kriptografi” “Teori e lojrave” e cila i mundëson njohjen e koncepteve bazë të kërkimit shkencor e cila do u shërbejë edhe në zhvillim e temës së diplomës. Gjithashtu, kjo i jep një bazë të fortë njohurishë për të gjitha ata që duan të ndjekin një program studimi të ciklit të tretë doktoraturë. Në semestrin e katërt zhvillohet punimi i diplomës. Procesi mësimor kryhet në salla dhe laboratorë për punë kërkimore. [Evidenca 1.5 Plani i zhvillimit strategjik te programit te studimit Msc ne Matematike] [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.5 plani 21-24 i vulosur]

	[Evidenca 4.13 Infrastruktura, kapacitete FSHN]
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	<i>Ky program studimi nuk përfshin në planin mësimor praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse pra punimi i diplomës zën 12 kredite më shumë sesa baza ligjore në fuqi. Gjithashtu, në semestrin e katërt dhe të fundit, studenti duhet të zhvillojë një punim në kuadrin e temës së masterit. Udhëheqësi është staf i brendshëm i FSHN. Sipas rregullores së programit të studimit, studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa shlyer të gjitha detyrimet akademike (të ketë shlyer me sukses të gjitha lëndët e planit mësimor) dhe financiare të programit të studimit.</i> [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 3.47 Rregullore e Diplomimit]
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet pasi programi i studimit në fjalë nuk është për Mësuesi
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet pasi Universiteti i Tiranës nuk klasifikohet si IAL me status të veçantë.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të	Nuk aplikohet pasi Universiteti i Tiranës nuk klasifikohet si IAL me status të veçantë.

ministrisë përgjegjëse për arsimin.				
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit "Master i Shkencave në Matematikë", i ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, është në përputhje me kriterin e përcaktuar. Struktura dhe përmbajtja mësimore e tij kanë ngjashmëri mbi 70% me programet e tjera të së njëjtës fushë dhe me të njëjtën emërtesë në nivel kombëtar, siç është rasti i Universitetit të Vlorës. Përmbajtja e programit është harmonizuar me udhëzimet dhe standardet kombëtare, duke garantuar koherencë të lartë akademike dhe kërkimore me programet ekuivalente të këtij cikli studimi. https://univlori.edu.al/programet/MSC https://www.fshn.edu.al/Departments/departamenti-i-matematikes/Programmes/matematike-msc			
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit 'Master i Shkencave në Matematikë' është i kodifikuar sipas VKM nr. 310, datë 11.05.2022 dhe kod i tij është: 72MS0541S. Kodifikimi i lëndëve të programit akoma nuk është kryer.			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky kriter nuk aplikohet pasi programi i studimit Master i Shkencave në Matematikë ofrohet tërësisht nga Universiteti i Tiranës, ndaj, nuk është një program i cili ofrohet nga dy ose më shumë institucione të arsimit të lartë.			
Konkluzione	<i>Programi "Master i Shkencave në Matematikë" përmbush kryesisht Standardin II/1. Struktura akademike është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kërkesat e sistemit ECTS, me shpërndarje të qartë të krediteve dhe përmbajtje të avancuar akademike. Megjithatë, mungon përfshirja e praktikës profesionale në planin mësimor dhe procesi i kodifikimit të programit është kryer.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e	Njësia kryesore e cila ofron programin e studimit është Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Ajo përbëhet nga 9 njësi bazë (8 Departamente

studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	dhe një Qendër Kërkimore). Departamenti i cili ofron programin e studimit është Departamenti i Matematikës. Struktura dhe funksionet e njësive kryesore dhe njësive bazë janë të detajuara në rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe është në fazë përditësimi. Rregullorja është në përputhje me Statutin e UMT dhe me Rregulloren e Brendshme të UT. Të gjitha rregulloret që organizojnë funksionimin e institucionit janë në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] Departamenti i Matematikës ka në përbërjen e tij një staf që përfshin 15 pedagogë me kohë të plotë – nga të cilët 3 janë Profesor Doktor, 7 janë Profesorë të asociuar, 5 mbajnë titullin Doktor. Universiteti i Tiranës është akredituar në nivelin institucional me vendim të bordit të akreditimit nr. 62, datë 21.09.2017, nr. 84 datë 27.10.2018 dhe nr. 04, datë 27.01.2023 është riakredituar dhe ka marrë vlerësimin maksimal prej 6 viteve. [Evidenca 1.7 Personeli akademik i Departamentit të Matematikës dhe kualifikimi i tij] [Evidenca 2.12 Lista e stafit akademik DM] [Tabela 1 ASCAL] [Evidenca 6.31 Vendim i Ascal mbi akreditimin e institucional]
Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik / administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Departamenti i Matematikës i cili është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë mësimore. Në funksion të programit të studimit është edhe zv. Dekani për kurrikulat i cili mbikëqyr gjithë procesin mësimor. Drejtuesi i departamentit mbështetet nga dy figura akademike për mbarëvajtjen e procesit mësimor që janë: përgjegjësi i grupit mësimor-kërkimor dhe kujdestari akademik i studentit (për programin e studimit). Lëndët e programit të studimit, duke qenë ky i nivelit Master i Shkencave, mbulohet në formë tërësore (teori dhe seminar/laborator) nga lektori i lëndës i cili mban së paku gradën Dr. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 2.11 Titullaret e grupeve mesimore-kerkimore] [Evidenca 2.15 Lista e kujdestareve per studentet e cdo viti Programit Master Shkencor ne Matematik] [Tabela 4 ASCAL]
Kriteri 3. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe	<i>Programi i studimit nuk ka një koordinator të emëruar specifikisht për menaxhimin e programit, siç parashikon kriteri. Detyrat dhe përgjegjësitë që zakonisht i takojnë koordinitorit ushtrohen nga drejtuesi i Departamentit në bashkëpunim me grupet mësimore-kërkimore, duke mundësuar mbikëqyrjen e përgjithshme akademike dhe administrative të programit. Gjithashtu, programi i studimit nuk përfshin komponentin e praktikës profesionale në strukturën e tij kurrikulare, gjë që kufizon</i>

praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	mundësinë për zhvillimin e aftësive praktike dhe të zbatueshme në tregun e punës. [Evidenca 2.19 Kerkes dhe vendim per ndryshim mbi planet mesimore]			
Konkluzione	<i>Programi i studimit "Master i Shkencave në Matematikë" përmbush Standardin II2. Njësia përgjegjëse, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Matematikës, janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe mbështetet në një strukturë të qartë akademike dhe staf të kualifikuar. Megjithatë, programi nuk ka një koordinator të emëruar zyrtarisht; funksionet përkatëse ushtrohen nga drejtuesi i departamentit në bashkëpunim me përgjegjësit e grupeve mësimore-kërkimore. Gjithashtu, mungon komponenti i praktikës profesionale në kurrikul.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti i Matematikës pjesë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në Matematikë. Departamenti disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ruhen dhe arkivohen ne arkivat e UT, konkretisht: • Të dhëna të përgjithshme mbi programin, objektivat formuese, synimet, kriteret përzgjedhëse, regjistrimet, transferimet, tarifat, etj. • Rregullorja e Departamentit. • Rregullorja e programit. • Dosje e programit të studimit. • Rregullorja e diplomimit. • Plani mësimor. • Sillabuset e lëndëve si dhe ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese (në dy gjuhë: shqip dhe anglisht). • CV e personelit akademik. • Ngarkesa mësimore. Krahas informacionit në lidhje me programin (planin, sillabuset, ngarkesën mësimore, etj.), departamenti mban të arkivuar edhe të gjitha vendimet në lidhje me studentët, si transferimet nga programe të tjera studimi, njohje lëndësh nga programe shkëmbimet (si p.sh., shkëmbime Erasmus), dhe çdo vendim tjetër ku vendimmarrja është kompetencë e departamentit. Informacionet në lidhje me ecurinë akademike si:

	pjesëmarrja në leksione dhe vlerësimet, janë kompetencë e sekretarisë mësimore. [Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Matematikës] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.13 CV shqip dhe anglisht Programi Master] [Evidenca 2.20 Dosja e plote e programit të studimit Master Shkencor] [Evidenca 3.47 Rregullore e Diplomimit] [Evidenca 4.2 Model Ngarkese e Departamentit të Matematikës]
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor/ jashtë auditorit.	Siç u cilësua në kriterin e mësipërm, Departamenti mban të arkivuar planin mësimor me të gjitha ndryshimet që ka pësuar në vite, dhe për çdo vit akademik, syllabuset e lëndëve të aktivizuara për vitin akademik. Në përputhje të plotë me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të Lartë”, dhe udhëzimeve përkatëse plani mësimor ka të përcaktuar emërtimin e plotë të programit të studimit, dhe vitin akademik ku aplikohet ky plan si dhe lëndët të ndara në semestër. Çdo lëndë karakterizohet nga të dhënat përkatëse si: kodi i lëndës (<i>ky nuk ekziston në syllabus</i>), emërtimi i lëndës, tipologjia e lëndës (sipas kategorive A-E), numri i krediteve (i plotë dhe i shpërndarë në peshën e teorisë, seminarit, laboratorit, dhe projektit), shpërndarja e numrit të orëve (i plotë dhe i shpërndarë në peshën e teorisë, seminarit, laboratorit, projektit dhe orëve individuale). Shpërndarja sipas në tipologjive është bërë në përputhje me VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, i ndryshuar, dhe përkatësisht programi i studimit ka: 13 ECTS (A), 60 ECTS (B), 12 ECTS (C), 5 ECTS (D) dhe 30 ECTS (E). Ngarkesa mësimore në auditor është 1200 orë kurse jashtë auditorit 1800 orë, e ndarë në vite, viti I 600 orë në auditor dhe 900 jashtë auditorit, viti II 600 orë në auditor dhe 900 jashtë auditorit. [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht]
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Rregullorja e programit të studimit ka të përcaktuar një serë rregullash në lidhje me regjistrimin e studentëve në programin mësimor dhe ecurinë e tyre. Gjithashtu ajo përcakton qartë kriteret e pranimit të studentëve si p.sh.: programet e ciklit të parë në të cilat studentët duhet të kenë kryer studimet, kriteret e njohjes së gjuhës së huaj apo mesatarja në hyrje. Procedurat për transferimin dhe ekuivalentimin e krediteve janë të përcaktuara qartë dhe zbatohen sipas rregullores së UT. Për sa i përket transferimit të studentëve nga programe të tjera studimi, çdo kërkesë vlerësohet nga një komision ad-hoc i cili ngrihet çdo fillim viti akademik, që vlerëson përputhjet e syllabuseve të lëndëve të fituara nga programe të tjera me syllabuset e lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave në Matematikë dhe rrjedhimisht bën njohjen e lëndëve. [Evidenca 1.3 Rregullore e UT]

	[Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 5.1 Transferim Studimesh] [Evidenca 5.2 Miratim komisioni ad-hoc per deget e dyta dhe transferimet]
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Në fillimit të çdo semestri, Departamenti mbledh dhe arkivon të gjitha syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik në fjalë duke krijuar një historik të plotë të syllabuseve të ofruara ndër vite. Syllabuset mbahen në dy gjuhë, shqip dhe anglisht, pavarësisht nga gjuha e programit të studimit. Ky arkiv mundëson ofrimin e syllabuseve studentëve që e kërkojnë atë si shërbim duke i vënë në dispozicion syllabusin e lëndës specifike kur studenti e ka ndjekur lëndën (sipas vitit akademik përkatës). Syllabusi është në përputhje me VKM nr. 41, Dt.24.01.2018, i ndryshuar, dhe firmoset nga titullari, i cili certifikon përmbajtjen lëndore si dhe përgjegjësi i departamentit, i cili certifikon përputhshmërinë me planin mësimor dhe rregulloret përkatëse. Gjithashtu syllabuset paqyrojnë qartë ngarkesat në auditor dhe jashtë tij, punën e pavarur, detyrat e kurset dhe përgatitjen për provimin në diplomë. Syllabuset në formën e tyre të shkurtuar janë të publikuara në faqen zyrtare të FSHN. [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht+] [Tabela 15 ASCAL]
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Çdo fillim viti akademik, Departamenti harton planin mësimor të aplikuar për vitin akademik përkatës. Planet mesimore hartohen në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me përgjegjësit e grupeve mësimore-kërkimore, në formë periodike vlerëson ndryshimet e nevojshme dhe i përcjell në Departament. Departamenti, brenda muajit prill i përcjell në dekanat dhe pastaj në senat për aprovimet përkatëse në mënyrë të brenda muajit maj të përcillet një njohje MAS. Ky program studimi ka pasë ndryshim në planin mësimor. Ndryshimet kanë qënë deri në masën 20% dhe lënda 'Kriptografi dhe Teori kodimi' është ndarë në dy lëndë 'Kriptografi' dhe 'Teori kodimi'. Dosja e prgramit të studimit ruhet në gjuhën shqipe dhe në anglisht ku përmban: planin mësimor, syllabuset, rregulloret, CV e stafit akademik, analizat vjetore të Departamentit, etj. [Evidenca 2.8 Faqe e procesverbalit nga mbledhja e DM per kurrikulen] [Evidenca 2.19 Kerkes dhe vendim per ndryshim mbi planet mesimore] [Evidenca 2.20 Dosja e plote e programit te studimit Master Shkencor]
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master në Matematikë përmbush plotësisht kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë. Departamenti disponon dhe arkivon dokumentacionin e nevojshëm (planin mësimor, syllabuset, rregulloret, CV e stafit), në përputhje me VKM nr. 41 dhe rregulloret e UT. Janë të qarta procedurat për pranimin, transferimin dhe njohjen e krediteve. Përmbajtja e programit vlerësohet dhe përditësohet rregullisht. Standardi konsiderohet i përmbushur plotësisht.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i lëndëve është i tillë që të japë një ide të përgjithshme të përmbajtjes. Disa nga lëndët si Gjeometri, Algjebër, Probabilitet janë në nivel të “avancuar” për t’i dalluar nga lëndë me të njëjtin emër që zhvillohen në programe në ciklet e para të studimit (kryesisht në programin Bachelor në Matematikë). Në vitin e parë, janë caktuar disa lëndë që i konsiderojmë me karakter të përgjithshëm dhe të nevojshme për programet në fushën Matematikës si Topologji dhe integrim, Analizë hilbertiane, ekuacione diferenciale. Në vitin e dytë, studentë ka mundësi të ndjekë lëndë profilizuese për programin e studimit si: Ekuacionet e fizikë matematike, Grupet topologjike, Dinamikat topologjike. Këto lëndë janë në linjë konsistente me thelbin e programit të studimit si dhe kërkesat e tregut të punës. Plani përmban gjithashtu edhe lëndë të karakterit praktik dhe ndërdisiplinor si Teori e Lojërave, Kriptografi, Analizë numerike. Titulli, përmbajtja e aktiviteteve, si dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave në programin e studimit, kontribuojnë në thellimin e njohurive në fushat e Matematikës teorike. [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 5.16 Studimi i Tregut të Punës UT FSHN] [Evidenca 5.17 Studimi i Tregut të punës DM]
Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërimit shkencor.	Programi i studimit Master i Shkencave në Matematikë, është organizuar sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. dt. 24.01.2018 i ndryshuar. Lëndët dhe raporti i tyre (ngarkesa në orë/ kredite) është përcaktuar në përputhje me këto akte ligjore dhe nënligjore duke synuar njëkohësisht përafrimin me programe të ngjashme ndërkombëtare. Plani mësimor është i ndarë në 2 vite akademike, pra, në katër semestra. Semestri i fundit përfshin punimin e diplomës. Çdo semestër ka një ngarkesë prej 30 ECTS dhe një numër prej 4 ose 5 lëndësh për semester. Çdo lëndë ka 3, 6 ose 9 ECTS. Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep një modul\ lëndë në përmbushje të objektivave formuese të programit. Ngarkesa totale e programit është 1200 orë në auditor dhe 1800 orë jashtë auditorit. Për sa i përket kërimit shkencor, ndërtim i kësaj kompetencë realizohet me punimin e diplomës me një ngarkesë prej 30 ECTS.

	[Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht]
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Në planin mësimor, për çdo lëndë, janë të përcaktuar ndarja e krediteve sipas tipologjisë së mësimdhënies (teori, seminare, laborator, etj.) që pasqyron edhe ngarkesën në auditorë për orët respektive me formulën 1 ECTS – 10 orë mësimore. Në syllabus përcaktohet edhe raporti orar për secilën lëndë. Ngarkesa e leksioneve në auditor është 20 orë në javë. Për çdo ECTS ofrohen 10 orë mësimore në auditor (300 orë për semestër e ndarë në 15 javë mësimore). Tregues që ky program është në përputhje me programe ndërkombëtare është kryerja e doktoratës jashtë vendit. [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Tabelat 9, 10, 13 ASCAL] [Evidenca 2.7 Certifikat e doktoratures]
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ky program siguron një ndarje të qartë sipas veprimtarive formuese dhe raportit teori/ praktikë dhe mundëson transferim të studimeve. Gjithashtu ky raport mundëson zhvillimin e kompetencave profesionale në lidhje me qëllimet formuese të ciklit të dytë të studimit. [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 5.1 Transferim Studimesh] [Evidenca 5.2 Miratim komisioni ad-hoc për deget e dyta dhe transferimet] Përputhshmëria në përmbajtje të programit të studimit bën të mundur edhe mobilitetin e studentëve në universitete të ndryshme të Evropës me anë të programit Erasmus+. Megjithatë, nuk ka pasur student që të ketë shfrytëzuar mobilitetin në marrëveshjet që UT disponon me universitete të ndryshme. Studentët e këtij programi studimi janë të punësuar në IAL, institute kërkimore, kompani të TIK, sektori bankar, .. etj. Gjithashtu ndjekun doktoratën në institucione brenda dhe jashtë vëndit. [Evidenca 1.8 Marrëveshjet e FSHN] [Evidenca 5.18 Rregullore-e-komisionit-të-mbarëvajtjes-së-veprimtarisë-dhe-marrëdhënieve-me-studentët] [Evidenca 5.19 Komisioni për pranimet në MSc] [Evidenca 6.20 Raporti i Gjurmimit]
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset e programit të studimit përmbajnë të gjitha elementet sipas shtojcës përkatëse të VKM nr. 41, datë.24.01.2018, i ndryshuar, duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura. Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë të detyrueshme dhe literature ndihmëse. Përditësimi i përmbajtjes së syllabuseve arrin deri në masë 20% dhe koordinohet nga drejtuesi i departamentit në bashkëpunim me përgjegjësit e grupeve mësimore-kërkimore, titullarët e lëndëve, të cilët

	njëkohësisht monitorojnë realizimin e lëndës në përputhje me syllabusin e miratuar. Botimet e reja të fushave përkatëse të studimit, rezultatet e punës shkencore, kryesisht ato të pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe të botimeve brenda dhe jashtë vendit, shpesh integrohen me koncepte të lëndëve përkatëse, ku njohuritë e përvetësuara u paraqiten studenteve për diskutim. Literatura është në shqip dhe në gjuhën Angleze. Për sa i përket teksteve me karakter teknik materialet janë të përgatitura nga pedagogu në formën e leksioneve të shtypura. [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.11 Titullaret e grupeve mesimore-kerkimore] [Evidenca 2.19 Kerkes dhe vendim per ndryshim mbi planet mesimore] [Evidenca 2.20 Dosja e plote eprogramit te studimit Master Shkencor]
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Mënyra e hartimit të kurikulës studimore dhe përmbajtja e programeve (syllabuseve) të studimit garanton përfitim maksimal të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Matematikë. Stafi akademik i përfshirë në mësimdhënie ka përvojë disa vjeçare në arsim si dhe fusha e studimit të tyre është në përputhje me lëndët që ato ofrojnë duke garantuar kështu efikasitetin maksimal gjatë mësimdhënies. Ambientet laboratorike i japin mundësinë studentëve të praktikojnë njohuritë e tyre në sisteme konkrete dhe koherente me tregun e punës. Pjesë e rëndësishme e zhvillimit të kompetencave janë edhe leksionet e hapura organizuar nga stafi dhe partner të jashtëm. [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.12 Lista e stafit akademik DM] [Evidenca 2.21 Leksionet e hapura të zhvilluara nga DM] [Evidenca 4.11 Foto te laboratorit te Matematikes] [Evidenca 4.12 Foto te pajisjeve audio vizive te departamentit]
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë disiplinash matematikore të përputhshme me nën-disiplinat, që vijnë në ndihmë të realizimit të misionit dhe qëllimit të institucionit për formimin e studenteve në studimet e mëtejshme doktrale. Programi i studimit merr parasysh nevojat e tregut shqiptar për studime në matematikë teorike në sektorit privat ashtu edhe në atë publik. Programi përfshin fusha të aplikuara si kriptografia, teoria e lojës, analiza e të dhënave ku nxisin mendim kritik dhe kompetencat matematikore në kontekste reale. [Evidenca 5.16 Studimi i Tregut te Punes UT FSHN] [Evidenca 5.17 Studimi i Tregut te punes DM] [Evidenca 6.20 Raporti i Gjurmimit]
Konkluzione	<i>Programi i studimit "Master i Shkencave në Matematikë" përmbush në mënyrë të plotë kërkesat e standardit II.4, duke siguruar përputhshmëri të strukturës dhe përmbajtjes me objektivat formues, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar të Kualifikimeve dhe Kuadrit Evropian të</i>

	<i>Kualifikimeve, rezultatet e të nxënit dhe kompetencat e nevojshme për tregun e punës. Organizimi i planit mësimor, shpërndarja e lëndëve dhe krediteve, përditësimi i syllabus-eve, përfshirja e lëndëve teorike dhe praktike, si dhe ndërlidhja me kërkimin shkencor dhe mobilitetin ndërkombëtar, garantojnë përfundimin e njohurive dhe aftësive që mundësojnë punësim apo vijim të studimeve të mëtejshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Programi i studimit përmirësohet dhe mbështetet nga aktorë dhe faktorë të ndryshëm, si institucionet publike dhe private, në bashkëpunim me të cilat janë organizuar aktivitete si Panairi i Karrierës dhe panairi “Work and Study”, si dhe nëpërmjet analizave të tregut të punës. Gjithashtu, përmirësimi mbështetet nga përfshirja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe nga përvojat studentore, përmes takimeve të hapura ndërmjet studentëve aktualë dhe të diplomuarve, si dhe organizimit të eventit “Java e Europës” për promovimin e mobilitetit akademik dhe integrimin në rrjete universitare evropiane. [Evidenca 3.6 CIMPA] [Evidenca 3.7 Projekt i financuar nga FSHN] [Evidenca 3.8 Workshop i organizuar nga Departamenti i Matematikës FSHN] [Evidenca 3.9 Projekti PKKZH E. Sila] [Evidenca 3.10 Projekti PIKSH] [Evidenca 5.15 Work and Study] [Evidenca 5.16 Studimi i Tregut të Punës UT FSHN] [Evidenca 5.17 Studimi i Tregut të Punës DM] [Evidenca 5.25 Career Planning] [Evidenca 6.18 Raport vjetor DSBCK] [Evidenca 6.20 Raporti i Gjurmimit]
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe	FSHN dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) kanë një bashkëpunim të mirë dhe mbledhin e analizojnë feedback-un nga studentët e diplomuar me qëllim përmirësimin e programit të studimit. DSBCK harton dhe analizon raporte periodike mbi vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Gjithashtu, kjo njësi organizon sondazhe me studentët aktualë dhe alumni, duke analizuar pritshmëritë e tregut të punës. Këto analiza përpilohen në raporte vjetore dhe marrin

reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	parasysh rekomandimet e marra, të cilat shërbejnë për përmirësimin e planit mësimor. Edhe vetë Departamenti zhvillon takime me të diplomuarit dhe studentët aktualë, të koordinuara nga kujdestarët akademikë dhe drejtuesi i departamentit. [Evidenca 2.15 Lista e kujdestareve për studentet e çdo viti Programit Master Shkencor në Matematik] [Evidenca 2.19 Kërkesë dhe vendim për ndryshim mbi planet mësimore] [Evidenca 6.13 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve 2023-2024] [Tabela 24 ASCAL] [Evidenca 6.18 Raport vjetor DSBCK]			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Përmirësimi dhe përditësimi i përmbajtjes së programit të studimit realizohet deri në masën 20% dhe arrihet në formë të ndryshme, duke reflektuar bashkëpunimet me aktorë dhe rrjete të ndryshme si: Shoqata Shqiptare e Matematikës, ku vihet theksi kryesisht në përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies dhe shkëmbimin e praktikave akademike; Ministria e Arsimit dhe Akademia e Shkencave, në kuadër të përditësimit të kurrikulave. Një tjetër parametër i rëndësishëm është roli i studentëve alumni, me të cilët organizohen rregullisht takime reflektuese dhe sugjeruese. Po ashtu, vlen të theksohet feedback-u i strukturuar nga DSBCK, i cili shërben si bazë për përshtatjen e programit me kërkesat e tregut të punës. [Evidenca 1.8 Marrëveshjet e FSHN] [Evidenca 2.3 Syllabusët shqip dhe anglisht] [Evidenca 5.25 Career Planning] [Evidenca 6.3 Njoftim për plotësimin e formularit të vlerësimit] [Evidenca 6.5 Statistika në nivel programi studimi, semestri i parë, viti akademik 2020-2021, (fq 130-142)] [Evidenca 6.8 Raport për pyetsorin "Raport i Studentëve", 2021-2022 FSHN UT (2)]			
Konkluzione	<i>Programi i studimit përmbush në mënyrë të plotë kërkesat e standardit II.5, duke siguruar përfshirjen aktive të studentëve, të diplomuarve dhe aktorëve të tregut të punës në përmirësimin e vazhdueshëm të tij. Bashkëpunimi me institucione publike dhe private, pjesëmarrja në rrjete dhe shoqata profesionale, analizat periodike të tregut të punës dhe feedback-u i strukturuar nga studentët dhe alumni, përbëjnë baza të qëndrueshme për përshtatjen e programit me zhvillimet bashkëkohore dhe kërkesat e tregut. Mekanizmat institucionalë si DSBCK dhe Departamenti garantojnë përditësim të rregullt të përmbajtjes dhe orientim drejt cilësisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Master i Shkencave në Matematikë është në përputhje të plotë me objektivat e UT dhe prioritetet strategjike të FSHN dhe programit të studimit. Mbështetur në rregulloren e departamentit dhe programit të studimit, përcaktohen qartë objektivat akademike dhe kërkimore. Ky program studimi ka për synim të përgatisë studentët me njohuri të avancuara në matematikën teorike dhe të aplikuar, si dhe me baza solide në shkencat kompjuterike dhe informatikë. Qëllimi është formimi i specialistëve të kualifikuar në kërkimin shkencor dhe në përdorimin e modelimeve matematike në kontekste të ndryshme ekonomike, duke i pajisur me kompetencat e nevojshme për t'u integruar menjëherë si në tregun e punës, ashtu edhe në fushën e kërkimit. Veprimtaria mësimore zhvillohet në sinkron me ndryshimet e zhvillimeve informatike në përgjithësi dhe ato të tregut të punës në veçanti. Përmbajtja e programit të studimit siç theksuam më lart, është hartuar për të ofruar jo vetëm njohuri dhe aftësim profesional por jep orientim të thelluar studentëve drejt studimeve dhe kërkimit shkencor. Me programin doktoral në të njëjtë fushë sikur e programit të studimit, Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka një fokus të veçantë drejt orientimit të disa studentëve me aftësi të veçanta analitike ti orientojë drejt projekteve kërkimore mundësisht në bashkëpunim me institucione Evropiane. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.2 Strategjia e Zhvillimit UT] [Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Matematikës] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit]
Kriteri 2. Njësia kryesore/ bazë nxiti, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Departamenti i Matematikës (si njësia bazë përgjegjëse e ofrimit të programit të studimit) ashtu edhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës (si njësia kryesore) janë përgjegjës për të gjitha aktivitetet që zhvillohen të kuadër të programit të studimit, si ato administrative dhe ato akademike. Departamenti bashkë me fakultetin, përgatisin në fillim të vitit ngarkesën mësimore duke kushtuar vëmendje të veçantë stafit të angazhuar në mësimdhënie, përgatisin orarin mësimor, mbledhin dhe vlerësojnë syllabuset e lëndëve të ofruara, dhe monitorojnë zhvillim e procesit mësimor në tërësinë e tij. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Matematikës] Gjithashtu, Departamenti promovon aktivitete të ndryshme në kuadrin e programit të studimit si seminare dhe workshop-e. Aktivitete të tilla kryesisht bashkërendohen me zyrën e ALUMNI-t ku një kontribut të vyer e japin vetë ish-studentët e FSHN-së. Gjithashtu Departamenti monitoron edhe veprimtarinë kërkimore të stafit akademik si dhe të studentëve të përfshirë në projekte të ndryshme.

	[Evidenca 1.5 Plani i zhvillimit strategjik te programit te studimit Msc ne Matematike] [Evidenca 2.21 Leksionet e hapura të zhvilluara nga DM] [Evidenca 2.26 Lista e projekteve dhe workshopeve të fituara] [Evidenca 2.28 Lista e mobiliteteve dhe pjesemarrje ne cost]
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Departamenti i Matematikës ka treguar një angazhim të dukshëm në përfshirjen aktive të studentëve të programit të studimit në veprimtari të ndryshme shkencore, duke kontribuar kështu në zhvillimin e kompetencave të tyre akademike dhe profesionale. Kjo përfshirje është realizuar në kuadër të aktiviteteve si konferenca shkencore studentore me rastin e 65 vjetorit të UT. Bashkëautorësi në publikime shkencore veçanërisht në punimin e diplomës. Organizimi i Shkollës verore dhe dimërore me qëllim krijimin e një kulture kërkimi dhe zhvillimi profesional të studentëve. Këto iniciativa pasurojnë përvojën e tyre akademike dhe forcojnë lidhjen ndërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kërkesave të tregut të punës. [Evidenca 2.22 Lista e disa prej studentëve]
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për realizimin e aktiviteteve kërkimore, UT ka dhënë mbështetje të plotë financiare për zhvillim e tyre. UT mbështet aktivitetet akademike, kërkimore dhe shkencore që organizohen në nivel Departamenti apo Fakulteti. Konkretisht në vitet 2018-2024 janë mbështetur shumë punime shkencore të stafit akademik (evidencë 4.21-4.24). Mbështetje logjistike dhe financiare e rëndësishme vjen dhe nga marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit që FSHN ka me institucione brenda dhe jashtë vendit. Personeli akademik mbështetet vazhdimisht nga UT-ja nëpërmjet financimeve direkte apo alternative, projekteve dhe donacioneve, si dhe në kuadër të mobilitetit në universitete të huaja. Këto praktika dëshmojnë angazhimin e FSHN për mbështetje financiare që ndihmon në zhvillim profesional të stafit akademik dhe krijon mundësi të përfshirjes së studentëve. [Evidenca 2.23 Lista e studenteve te programit Master Shkencor në Matematikë që janë pjesë e Programin Kombëtar të Praktikave të Punës] [Evidenca 3.7 Projekt i financuar nga FSHN] [Evidenca 3.8 Workshop i organizuar nga Departamenti i Matematikes FSHN] [Evidenca 3.9 Projekti PKKZH] [Evidenca 3.10 Projekti PIKSH]
Konkluzione	<i>Programi i studimit "Master i Shkencave në Matematikë" përmbush në mënyrë të plotë kërkesat e standardit II.6, duke ofruar një orientim të qartë drejt studimeve të avancuara dhe kërkimit shkencor. Objektivat e programit janë të përafëruara me prioritetet e institucionit, dhe struktura organizative siguron koordinim të mirë midis veprimtarive mësimore dhe kërkimore, duke respektuar lirinë akademike. Studentët inkurajohen dhe angazhohen në aktivitete kërkimore përmes konferencave, shkollave</i>

	<i>verore e dimërore dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare. Fakulteti dhe Departamenti ofrojnë mbështetje institucionale dhe financiare për zhvillimin e kërkimit, duke garantuar pjesëmarrjen aktive të stafit dhe studentëve në projekte dhe publikime shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	FSHN mbështetet nga projektet kërkimore shkencore të dhëna nga UT dhe siguron bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë si Akademia e Shkencave për realizimin e objektivave të programit të studimit. Marrëveshjet e FSHN-së inkurajojnë bashkëpunim ndërdisiplinor duke lehtësuar shkëmbimin shkencor të stafit akademik. [Evidenca 1.8 Marrëveshjet e FSHN] [Evidenca 2.26 Lista e projekteve dhe workshopeve të fituara] [Evidenca 3.9 Projekti PKKZH] Në zbatim të statutit të UT rregullores dhe strategjisë së zhvillimit të institucionit FSHN koordinon punën e vet në funksion të realizimit me sukses të veprimtarisë mësimore. Në këtë kuadër, orientimi i thelluar drejt kërkimit shkencor mbështetet edhe nga partneriteti dhe bashkëpunimi që FSHN dhe UT ka siguruar dhe siguron në vite. UT mbështet kërkimin shkencor me anë të programit “UT_Kërkim Ekselencë dhe inovacion” me qëllim mbështetje e stafit akademik për realizimin e objektivave kërkimore. Këto veprimtari raportohen nga çdo vit nga Departamenti dhe FSHN. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 3.24 Raport mbi analizen vjetore të Departamentit të Matematikës 2021-2022] [Evidenca 3.27 RAPORTI VJETOR FSHN UT 2023-2024]
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Universiteti i Tiranës, FSHN zotërojnë një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete të huaja dhe vendase, si dhe është i përfshirë si partner apo drejtues në projekte të shumta me fokus në kërkimin shkencor. Departamenti i Matematikës ka qenë aktiv në projekte kërkimore, të financuara nga AKKSHI dhe PKKZH si “Sfida e kurrikulës së re të Matematikës në arsimin universitar dhe ndikimi i saj në sistemin parauniversitar”. “Roli i laboratorit didaktik-informatik-kërkimor në përmirësimin e kërkimit shkencor në lidhje me mësimdhënien e matematikës”. “Ndikimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit në mësimdhënien e mësimnxënien e matematikës për arsimin e mesëm

	shqiptar”. Në kuadër marrëveshjeve me programin Erasmus + kanë përfituar bursa 2 pedagog të këtij programi studimi. [Evidenca 1.8 Marreveshjet e FSHN] [Evidenca 1.9 Marreveshjet me UT] [Evidenca 2.28 Lista e mobiliteteve dhe pjesëmarrje ne cost] [Evidenca 3.7 Projekt i financuar nga FSHN] [Evidenca 3.9 Projekti PKKZH] [Evidenca 3.10 Projekti PIKSH]
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) dhe Departamenti i Matematikës kanë organizuar një sërë veprimtarish shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, duke nxitur angazhimin akademik dhe shkëmbimin e përvojave: Konferenca Studentore Ndërkombëtare në kuadër të 65 vjetorit të UT. Projekti me titull: “Sfida e kurrikulës së re të Matematikës në arsimin parauniversitar dhe ndikimi i saj në arsimin universitar” i sponsorizuar nga UT, ku me këtë rast është organizuar edhe një Workshop për këtë temë. Shkolla verore me tema të kohës nga matematika e aplikuar, statistika dhe analiza. Leksione të hapura me tema: “Normal Numbers” me profesor nga Polonia. “Simfonitë matematikore që zgjerojnë interesin për matematikën” Webinar i organizuar nga Këshilli studentor. “Zbatime të vlerave vetiake dhe vektorëve vetiake në jetën reale” në TIMath 2022, Tirana International Mathematics Days. [Evidenca 2.21 Leksionet e hapura të zhvilluara nga DM] [Evidenca 2.22 Lista e disa prej studentëve] [Evidenca 3.6 CIMPA] [Evidenca 3.7 Projekt i financuar nga FSHN] [Evidenca 3.8 Workshop i organizuar nga Departamenti i Matematikës FSHN]
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Departamenti i Matematikës së Aplikuar ofron një formim akademik cilësor, duke përgatitur profesionistë të ardhshëm me standarde të larta profesionale dhe etike, të aftë për të kontribuar në zhvillimin kombëtar të vendit. Studimet e realizuara mbi tregun e punës tregojnë se ky program studimi ka një kërkesë të konsiderueshme dhe përgatit studentë që janë të konkureshëm në treg. Gjithashtu, shumë studentë të këtij programi kanë vazhduar studimet e doktoratës, janë punësuar në universitete dhe kompani të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. [Evidenca 1.5 Plani i zhvillimit strategjik te programit te studimit Msc ne Matematike] [Evidenca 1.8 Marreveshjet e FSHN] [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 3.24 Raport mbi analizen vjetore te Departamentit te Matematikes 2021-2022] [Evidenca 5.17 Studimi i Tregut te punes DM] [Evidenca 6.20 Raporti i Gjurmimit]

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive</i> , 2005/36/EU).	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.			
Konkluzione	<i>Bazuar në gjetjet e evidentuara, standardi është përmbushur plotësisht. Programi garanton një bazë të qëndrueshme kërkimore, përfshirë bashkëpunime të shumta institucionale, projekte kërkimore aktive, si dhe pjesëmarrje në programe ndërkombëtare si Erasmus+. FSHN dhe Departamenti i Matematikës organizojnë aktivitetet shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, duke nxitur ndërkombëtarizimin dhe përfshirjen e studentëve dhe stafit në kërkim. Programi përgatit profesionistë të kualifikuar dhe konkurrues për tregun e punës. Kjo tregon një përmbushje cilësore të objektivave të standardit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Rregullorja e UT, rregullorja e programit të studimit përcaktojnë se elementët kryesorë të mësimdhënies dhe nxënies janë: leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit, praktikatat mësimore, orët për leksionet e hapura dhe forma të tjera sipas rasteve gjithë materiali didaktik hidhet në platformën Microsoft Teams dhe studentët kanë mundësi ta marrin atë direkt nga sistemi ose në bibliotekën e FSHN. Për zhvillimin e orëve laboratorike, FSHN ofron laboratorë me kushte bashkëkohore. Laboratori përmban gjithashtu, një dërrasë interaktive, një workstation, 1 Cisco Lab, 1 Dron. Në syllabus janë parashikuar format e ndryshme të mësimdhënies dhe të kontrollit të dijeve. Në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies Departamenti ka organizuar dhe marrë pjesë në leksione të hapura, workshoos dhe marrë pjesë në projekte të ndryshme. [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 3.3 Manual për përdorimin e platformës Microsoft Teams] [Evidenca 3.4 Foto e derrases interaktive] [Evidenca 3.6 CIMPA] [Evidenca 3.7 Projekt i financuar nga FSHN] [Evidenca 3.8 Workshop i organizuar nga Departamenti i Matematikës FSHN] [Evidenca 3.16 Komunikim ne Teams me studentet] [Evidenca 3.20 Detyre kursi student] [Evidenca 3.44 Orari i konsultimeve me studentet] [Evidenca 4.11 Foto te laboratorit te Matematikës]
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Në lidhje me procesin mësimor, personeli akademik respekton rregulloret e Universitetit të Tiranës përsa i përket zhvillimit të orës mësimore, mënyrës së vlerësimit, përdorimit të literaturës dhe mjeteve të tjera të nevojshme. Personeli akademik merr parasysh natyrën specifike të programit të studimit dhe ka përdorur dhe aplikuar metoda të ndryshme të mësimdhënies. Një e veçantë e programeve të studimit të ofruara nga FSHN janë ndërthurja e aspekteve teorike me ato praktike. Metoda alternative të përdorura janë të tipit flipped classroom, si detyra autentike, debate. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht]

	Në kuadër të procesit të mësimdhënies, Universiteti i Tiranës ka miratuar Strategjinë Institucionale për Mësimdhënien dhe Planin Strategjik për Zhvillimin Profesional të personelit akademik. Objektivat kryesore të këtyre dokumenteve përfshijnë rishikimin e planeve mësimore, verifikimin e rezultateve të të nxënës dhe krijimin e metodave inovative të mësimdhënies. Gjithashtu, DSBC-ja ka hartuar pyetësin përkatës për matjen e kënaqësisë së studentit lidhur me alternativa të ndryshme të zhvillimit të procesit mësimor, rezultatet e të cilit kanë qenë objekt diskutimi dhe përmirësimi konkret në format e mësimdhënies. [Evidenca 3.11 Strategjia Institucionale për mësimdhënien, Universiteti i Tiranës 2022-2027] [Evidenca 3.12 Plani strategjik mbi zhvillimin profesional të personelit në Universitetin e Tiranës 2023-2028 si dhe programin e trajnimit për vitin 2023] [Evidenca 6.8 Raport për pyetësin "Raport i Studentëve", 2021-2022 FSHN UT (2)] [Evidenca 6.10 Raport për pyetësin "Raport i Studentëve", 2022-2023 FSHN UT_removed] [Evidenca 6.11 Raport "Vlerësimi i studentëve që diplomohen", 2023-2024 FSHN UT_removed] [Evidenca 6.12 Raport për pyetësin "Raport i Studentëve", 2023-2024 FSHN UT]
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Universiteti i Tiranës angazhohet për rekrutimin e stafit të kualifikuar dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive të tij, duke u karakterizuar nga qëndrueshmëria në përbërjen akademike. Në veçanti, stafi pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës është me moshë relativisht të re dhe i përfshirë në fusha të lidhura me teknologjinë, çka e bën tepër të hapur dhe dinamik ndaj përjasjes së metodave të reja të mësimdhënies. Në këtë kuadër, UT ka ngritur Qendrën Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit. Për të nxitur përdorimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie, FSHN organizon trajnime të vazhdueshme për stafin akademik, duke synuar fleksibilitet pedagogjik dhe përshtatje me rezultatet e pritshme të të nxënës. [Evidenca 3.11 Strategjia Institucionale për mësimdhënien, Universiteti i Tiranës 2022-2027] [Evidenca 3.12 Plani strategjik mbi zhvillimin profesional të personelit në Universitetin e Tiranës 2023-2028 si dhe programin e trajnimit për vitin 2023] [Evidenca 3.13 Vendim i Senatit Akademik Nr. 48, datë 25.11.2021. Ngritja e qendrës virtuale të zhvillimit profesional dhe trajnimit në Universitetin e Tiranës] [Evidenca 3.14 Trajnime të stafit të UT në qendrën virtuale dhe raport i trajnimeve] Gjithashtu, stafi përfiton nga programet e shkëmbimit me universitete partnere perëndimore dhe rajonale, në kuadër të marrëveshjeve të

	bashkëpunimit që ka nënshkruar UT, duke mundësuar shkëmbimin e praktikave të mira mbi planet mësimore dhe metodologjitë e mësimdhënies dhe të nxënies. Stafi është gjithashtu i angazhuar në leksione të hapura dhe workshop-e të ndryshme që lidhen me inovacionin pedagogjik dhe didaktik. [Evidenca 1.8 Marreveshjet e FSHN] [Evidenca 1.9 Marreveshjet me UT] [Evidenca 3.6 CIMPA] [Evidenca 3.7 Projekt i financuar nga FSHN] [Evidenca 3.8 Workshop i organizuar nga Departamenti i Matematikës FSHN] [Evidenca 3.44 Orari i konsultimeve me studentet]
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	UT në strategjinë e tij përfshin student në procesin e përmirësimit të kurrikulës. Stafi akademik është i specializuar në disiplina specifike, në të cilat është i angazhuar në mësimdhënie dhe zotëron kompetencat e nevojshme për të shpjeguar qartësisht njohuritë dhe konceptet përkatëse. Ata përdorin metoda të ndryshme mësimore, të përshtatura sipas temave dhe profileve, duke synuar zhvillimin e autonomisë dhe mendimit kritik te studentët. [Evidenca 1.7 Personeli akademik i Departamentit të Matematikës dhe kualifikimi i tij] [Evidenca 2.13 CV shqip dhe anglisht Programi Master] [Evidenca 3.22 Komisionet ne UT] [Tabelat 1, 2, 6, 7, 12 ASCAL] Pedagogët nxisin aftësitë individuale të studentëve, duke u krijuar hapësira për të shpalosur kreativitetin përmes detyrave dhe projekteve të kursit, të zhvilluara nën monitorimin dhe bashkëpunimin e ngushtë me ta. Këto ndërveprime përfshijnë ndarjen e vështirësive dhe reflektimeve deri në përfundimin e projektit. Metodot e përdorura përfshijnë detyra autentike, debate, prezantime nga studentët, projekte, detyra shtëpie dhe punë në grup, të cilat nxisin autonominë, bashkëpunimin dhe të menduarit kritik, duke ofruar njëkohësisht mbështetje të vazhdueshme nga pedagogët dhe duke krijuar një mjedis bashkëpunues për zhvillimin e vetëbesimit. Syllabuset përfshijnë lëndë me vlerësim të vazhdueshëm, ku studentët kanë mundësi të shprehin mendimin e tyre gjatë testimeve periodike të parashikuara. Pedagogët inkurajojnë studentët më të mirë drejt angazhimit në kërkimin shkencor, bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe përgatitjes së temës së diplomës, që mund të çojë në botime shkencore apo pjesëmarrje në konferenca. Një komunikim i hapur dhe i respektueshëm midis pedagogëve dhe studentëve mbështet këtë proces, duke siguruar që studentët të mos ndihen të neglizhuar, por të përfshirë në mënyrë aktive në mësimdhënie. [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 3.16 Komunikim ne Teams me studentet]

	[Evidenca 3.17 Ngarkime materiale ne Teams] [Evidenca 3.18 Komunikimi ne email me studentet] [Evidenca 3.19 Lista e programeve qe kane Detyre Kursi] [Evidenca 3.20 Detyre kursi student] [Evidenca 3.44 Orari i konsultimeve me studentet] [Evidenca 3.46 Pjesemarrje e studenteve ne Konferenca me Temen e Diplomes] Për realizimin efektiv të programit të studimit, ofrohen laboratorë bashkëkohorë, salla leksionesh, zyra të mjaftueshme dhe lehtësira të tjera të pajisura me teknologji moderne dhe mjete të informacionit. Shumica e ambienteve janë të përshtatura për të garantuar një proces efikas dhe cilësor të të nxëniet. Ndërkohë, komunikimi dhe marrëdhëniet ndërpersonale ndërtohen mbi bazat e Kodit të Etikës së Universitetit të Tiranës. [Evidenca 3.4 Foto e derrases interaktive] [Evidenca 3.21 Kodi i Etikes UT]
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti, në bashkëpunim me DSBC-në, vlerëson dhe përmirëson në mënyrë periodike format dhe metodat e mësimdhënies përmes Pyetësorit të Vlerësimit të pedagogut të lëndës, i cili përbën një nga mjetet kryesore për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Ky pyetësor administrohet përpara zhvillimit të provimit final të lëndës dhe rezultatet e tij shërbejnë si bazë për vendimmarrje në nivel institucional, duke kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të procesit mësimor. [Evidenca 6.8 Raport për pyetësin "Raport i Studentëve", 2021-2022 FSHN UT (2)] [Evidenca 6.10 Raport për pyetësin "Raport i Studentëve", 2022-2023 FSHN UT] [Evidenca 6.11 Raport "Vlerësimi i studenteve qe diplomohen", 2023-2024 FSHN UT] [Evidenca 6.12 Raport për pyetësin "Raport i Studentëve", 2023-2024 FSHN UT] [Evidenca 6.13 Raport vjetor per vlerësimin e cilesise se programeve 2023-2024] [Evidenca 6.15.1 Percjellje e pyetsoreve] [Evidenca 6.15.2 Percjellje e raporteve(c_mail) të hartuara nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës 2022] Departamenti i Matematikës garanton gjithashtu të drejtën e studentëve për të ankimuar rezultatet e vlerësimit të dijeve, duke ofruar kështu një proces transparent dhe të drejtë. Në mbështetje të programit të studimit, janë të angazhuar edhe kujdestarë akademikë (një për çdo vit studimi), të cilët kanë për detyrë përcjelljen e çdo problematike të studentëve pranë autoriteteve përkatëse, duke shërbyer si urë lidhëse ndërmjet studentëve dhe strukturave drejtuese të Fakultetit. [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit]

	[Evidenca 2.15 Lista e kujdestareve per studentet e cdo viti Programit Master Shkencor ne Matematike]
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni, në bashkëpunim me Departamentin dhe DSBC-në, organizon, koordinon dhe mbështet përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor përmes publikimeve, trajnimeve, leksioneve të hapura, workshoopeve. Universiteti i Tiranës inkurajon dhe motivon stafin akademik në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies. Institucioni ka përfshirë vazhdimisht në procesin mësimor lektorë të huaj dhe me eksperiencë, me qëllim promovimin e praktikave më të mira në rajon. Përmes Udhëzuesit për Programimin “UT Kërkimi, Ekselencë dhe Inovacion”, universiteti mbështet të gjitha njësitë akademike në mënyrë që rezultatet kërkimore të shfrytëzohen në funksion të mësimdhënies. Në përputhje me qasjet inovative, UT ka krijuar “Qendrën Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit” si dhe ka miratuar “Strategjinë Institucionale për Mësimdhënien”, të cilat synojnë zhvillimin e mëtejshëm të metodologjive pedagogjike dhe didaktike. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.2 Strategjia e Zhvillimit UT] [Evidenca 2.21 Leksionet e hapura të zhvilluara nga DM] [Evidenca 3.12 Plani strategjik mbi zhvillimin profesional të personelit në Universitetin e Tiranës 2023-2028 si dhe programin e trajnimit për vitin 2023] [Evidenca 3.13 Vendim i Senatit Akademik Nr. 48, datë 25.11.2021. Ngritja e ngritja e qendrës virtuale të zhvillimit profesional dhe trajnimit në Univesitetin e Tiranës] [Evidenca 3.14 Trajnime të stafit të UT në qendrën virtuale dhe raport i trajnimeve] [Evidenca 3.42 UT Kerkim Ekselence dhe Inovacion] Vlerësimi i aktivitetit mësimor realizohet nga Drejtuesi i Departamentit të Matematikës së Aplikuar, i cili, kur është e nevojshme, ndërhyr duke kontaktuar pedagogët për të komunikuar shqetësime që mund të kenë dalë nga studentët, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte. Kjo ndërhyrje synon, nga njëra anë, që pedagogët të marrin në dijeni komente për të cilat mund të mos jenë të informuar dhe, nga ana tjetër, të nxitet përmirësimi i qëndrimit dhe i metodës së tyre të mësimdhënies. Po ashtu, në nivel departamenti dhe fakulteti hartohen analiza dhe raporte që shërbejnë si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor. Për më tepër, institucioni ka miratuar Manualin e Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik, në të cilin përcaktohen qartë format dhe kategoritë përkatëse të metodave të vlerësimit të personelit. Përmes kanaleve të komunikimit institucional, si emaili dhe faqja zyrtare e internetit, promovohen shembuj të praktikave më të mira me qëllim përhapjen dhe nxitjen e tyre në të gjithë trupën akademike.

	[Evidenca 6.3 Njoftim për plotësimin e formularit të vlerësimit] [Evidenca 6.4 Rregullore DSBCK] [Evidenca 6.5 Statistika në nivel programi studimi, semestri i parë, viti akademik 2020-2021, (fq 130-142)] [Evidenca 6.8 Raport për pyetsorin "Raport i Studentëve", 2021-2022 FSHN UT] [Evidenca 6.15.1 Përcjellje e pyetsoreve] [Evidenca 6.15.2 Përcjellje e raporteve(e_mail) të hartuara nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës 2022] [Evidenca 6.22 Vendim Nr. 30, datë 22.07.2021 i Senatit Akademik (Për miratimin e manualit të vlerësimit të performancës së personelit akademik të UT)] [Evidenca 6.23 Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës]			
Konkluzione	<i>Institucioni garanton proces të nxënies cilësore dhe me në qendër studentin, duke zbatuar metoda të ndryshme mësimdhënieje (leksione, seminare, laboratorë, projekte, praktika) dhe forma alternative si "flipped classroom" e debate. Staf akademik është i kualifikuar, përdor metoda interaktive, mbështet zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, si dhe ruan marrëdhënie respekti me studentët. Studentët përfshihen në vlerësimin dhe përmirësimin e procesit mësimor, përmes pyetësorëve dhe kujdestarëve akademikë. Institucioni mbështet zhvillimin profesional të stafit përmes trajnimeve, qendrës virtuale, strategjive institucionale dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare. Vlerësimi i mësimdhënies është periodik dhe i strukturuar, i orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm. Infrastruktura dhe mjetet didaktike janë bashkëkohore dhe në funksion të rritjes së cilësisë. Standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të	Plani Strategjik UT i referohet procesit mësimor si një nga tre qëllimet kryesore strategjike (mësimdhënie, kërkim shkencor, shërbim ndaj komunitetit) të universitetit. Ndër të tjera, në Planin Strategjik të UT-së institucioni ka vendosur qëllime si: përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit duke hapur programe studimore inovative dhe ndër-disiplinore; përmirësimi i kurrikulës; dhe Përmirësimi i metodologjisë së mësimdhënies. Institucioni ka përcaktuar në strategji

posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	disa instrumente për të matur arritjen e qëllimeve të lartpërmendura: Rishikimi i kurrikulës, për integrimin e aftësive të të menduarit kritik dhe sipërmarrjes. Trajnimi i Fakulteteve për hartimin e lëndëve sipas sistemit të Bolonjës, inkurajon stafin të vlerësojë në mënyrë kritike filozofinë dhe metodologjinë e tyre të mësimdhënies. Çdo vit organizohen seanca trajnimi nga DSBC në bashkëpunim me personel akademik të FSHN në lidhje me përdorimin e teknologjisë në përgatitjen e materialeve mësimore dhe vlerësimin e tyre. Lektorët inkurajohen për të përditësuar syllabuset e lëndëve të tyre në përgjigje të tendencave të tregut. Për të qëndruar në linjë me zhvillimet më të fundit teknologjike, inkurajohet përdorimi i programeve të simulimit dhe programeve të tjera aplikuese. Mënyrat e testimit, periudhat e kontrollit, rezultatet dhe ankimimet janë të përcaktuara në Rregulloren e UT, rregulloren e programit të studimit, si dhe të publikuara në faqet zyrtare të UT dhe FSHN. Kujdestarët akademikë i orientojnë studentët në lidhje me këto dokumente. [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.5 Plani i zhvillimit strategjik të programit të studimit Msc në Matematikë] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 2.2 Planet mësimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.15 Lista e kujdestareve për studentet e çdo viti Programit Master Shkencor në Matematikë] [Evidenca 2.21 Leksionet e hapura të zhvilluara nga DM]
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/ moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	Gjatë javës së orientimit dhe në fillim të semestrit, studentët njihen me syllabuset e lëndëve, të cilat u shpjegohen nga pedagogët edhe në orën e parë të leksionit. Në syllabus janë të përcaktuara metodologjitë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave, si edhe format e ndryshme të mësimdhënies. Testimi dhe vlerësimi realizohen nëpërmjet një kombinimi të kontrollit të vazhdueshëm gjatë semestrit dhe provimit përfundimtar, në përputhje me raportin e vlerësimit të parashikuar në secilin syllabus. Syllabuset në formë të shkurtuar janë edhe në faqen web të FSHN. [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht]
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Aplikimi i formave tradicionale dhe i mjeteve digjitale të vetëvlerësimit reflekton stilet e ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënies, duke e bërë vlerësimin një pjesë integrale të procesit mësimor. Ky proces i mundëson studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Nxitja e studentëve për të shfaqur njohuritë dhe aftësitë e tyre realizohet përmes detyrave të kursit, projekteve dhe angazhimit interaktiv gjatë orëve të mësimi. Pavarësisht formateve standarde, përmbajtja e tezave

	të provimit i përshtatet natyrës së lëndës, me synimin për të lehtësuar shprehjen e aftësive dhe njohurive të përvetësuara nga studentët. Kontrolli i njohurive nuk paraqet qëllim në vetvete, por synon përgatitjen sa më cilësore të studentëve në funksion të kontributit që ata do të japin në sektorët ku do të angazhohen. Në fund të çdo semestri, studentët kanë mundësinë të plotësojnë një anketë për vlerësimin e secilit pedagog. Anketa është ndërtuar mbi përvojën e universiteteve të njohura ndërkombëtare dhe përfshin pyetje të ndryshme që synojnë të vlerësojnë aspekte të shumta në lidhje me lëndën dhe punën e pedagogut. Krahas provimit final, përdoret edhe vlerësimi i vazhduar, i cili u jep studentëve mundësinë të testohen disa herë gjatë semestrit ose vitit akademik. Studentët janë gjithashtu në kontakt të vazhdueshëm me Këshilltarët Akademikë, të cilët u ofrojnë mbështetje dhe orientim, duke u mundësuar atyre të ndajnë shqetësimet e tyre në lidhje me një lëndë të caktuar ose me pedagogët përkatës. [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.15 Lista e kujdestareve për studentet e çdo viti Programit Master Shkencor në Matematikë] [Evidenca 6.8 Raport për pyetsorin "Raport i Studentëve", 2021-2022 FSHN UT (2)] [Evidenca 6.12 Raport për pyetësorin "Raport i Studentëve", 2023-2024 FSHN UT] [Evidenca 6.13 Raport vjetor për vlerësimin e cilësive të programeve 2023-2024 (1)]			
Konkluzione	<i>Institucioni ka rregullore dhe procedura të qarta për testimin dhe vlerësimin, të publikuara dhe të njohura nga studentët. Metodatat e vlerësimit përcaktohen në syllabus dhe u komunikohen studentëve në fillim të çdo lënde. Vlerësimi është i shumëllojshëm (teste, detyra, projekte, provim final), duke u përshtatur me natyrën e lëndës dhe duke lejuar studentët të shprehin njohuritë dhe aftësitë e tyre. Aplikohen forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe studentët kanë mundësi ankimi dhe mbështetje nga kujdestarët akademikë. Vlerësimi i mësimdhënies bëhet rregullisht përmes anketave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Departamenti i Matematikës, me qëllim sigurimin e një angazhimi të vazhdueshëm të studentëve dhe të thellimit të njohurive të tyre, ka një

profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	strukturë të mirëpërcaktuar për kontrollin dhe testimin gjatë gjithë vitit akademik. Në bazë të Vendimit të Senatit nr. 119, datë 26.02.2019, vlerësimi i njohurive të studentëve bazohet në pikët e grumbulluara gjatë vitit sipas këtyre komponentëve: • vlerësimi i pjesëmarrjes; • vlerësimi i aktivizimit gjatë mësim; • laboratorët, në varësi të lëndës; • detyra e kursit, në varësi të lëndës; • provimi i ndërmjetëm. Përqindja e secilit komponent nuk është fikse dhe ndryshon nga një lëndë në tjetrën, në varësi të specifikave të lëndës dhe të vlerësimit të bërë nga pedagogu. Provimi përfundimtar zë jo më pak se 70% të vlerësimit total. Të gjitha komponentët e vlerësimit janë të përcaktuara në syllabusin e lëndës, i cili miratohet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me drejtuesin e Departamentit. Ky sistem i integruar i vlerësimit synon të motivojë studentët për një angazhim të vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit. Në të njëjtën kohë, i jep pedagogut mundësinë të monitorojë progresin dhe të adresojë paqartësitë e studentëve. Gjithashtu, për disa lëndë aplikohet vlerësimi i vazhduar, ku studenti testohet 2–3 herë gjatë semestrit dhe secili vlerësim mund të përfaqësojë deri në 40% të vlerësimit total. Rezultati përfundimtar konvertohet në notë përfundimtare. [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 3.28 Program lendor Viv]
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Për të garantuar një proces transparent, objektiv dhe efikas të vlerësimit të njohurive të studentëve, Fakulteti i Shkencave Natyrore (FSHN) ka mundur zhvillimin e tij me efektivitet maksimal. Përmes përdorimit të platformave digjitale, pedagogët dhe studentët kanë realizuar të gjitha proceset mësimore, duke ruajtur transparencën dhe duke minimizuar mundësitë për abuzim si në kontrollin e vazhdueshëm, ashtu edhe në testimin final të studentëve. Platformat MS Teams dhe Google Classroom përdoren në shërbim të programit të studimit, ku përveçse shërbejnë për shpërndarjen e materialeve dhe organizimin e mësim, ofrojnë gjithashtu mundësinë për zhvillimin e testeve online, duke garantuar një vlerësim transparent dhe objektiv. [Evidenca 3.1 Udhezues_i_UT_per_mesimin_ne_distance_f2c2b81980] [Evidenca 3.2 Rregullore e UT mbi zhvillimin të provimeve online] [Evidenca 3.3 Manual për përdorimin e platformës Microsoft Teams]
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Titullari i lëndës, ose lektori në rastet kur nuk është titullar, janë përgjegjës për procesin e vlerësimit dhe për përcaktimin e notës përfundimtare të studentit. Provimi përfundimtar përbën jo më pak se 70% të vlerësimit total. Të gjitha detyrimet e studentit janë të përcaktuara në syllabusin e lëndës, ndërsa rregullat për zhvillimin e

	provimeve dhe sistemi i vlerësimit janë në përputhje me rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e sekretarisë mësimore. [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 3.38 Sekretaria Mesimore]
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i njohurive të studentëve kryhet nëpërmjet fazave të ndryshme të kontrollit gjatë semestrit (teste, provimi i ndërmjetëm, punë laborator, detyrë kursi, provim final). Pas secilës fazë, studenti njihet me vlerësimin e tij në formë individuale, shpjegimin e gabimeve dhe mundësinë për përmirësim në të ardhmen. Përtej kontroleve, studentëve u jepen detyra gjatë gjithë zhvillimit të lëndës, për të konstatuar dhe angazhimin e tij të vazhdueshëm. Në procesin e vlerësimit përfundimtar (provimi final), pas korrigjimit të provimeve dhe shpalljes së rezultateve nga pedagogu i lëndës, sipas rregullores së programit të studimit, studentëve i jepet një afat tre ditë për të rishikuar provimin, për të kuptuar ku ka gabuar dhe për të këshilluar me pedagogun në vijim. [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit]
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/ nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Çdo anëtar i stafit akademik dhe jo akademik në FSHN, ka si detyrim të ndjekë kodin e etikës lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes dhe masave ndëshkuese në raste plagjiature apo kopjimi. Në rastet kur vërehen raste plagjiature/ kopjimi, pedagogu i lëndës drejtohet te përgjegjësi i Departamentit dhe në varësi të problematikës mund të ngrihet këshilli i etikës dhe të merren masat përkatëse ndëshkimore. Secili pedagog është përgjegjës për garantimin e një niveli të lartë të ndershmërisë në çdo kohë. Ndërkohë, përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani, vazhdimisht mbajnë kontakte me pedagogët, për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor. Rregullorja për kontrollin antiplagjiaturë është në fazë hartimi. FSHN nuk ka një soft antiplagjiaturë. [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 3.21 Kodi i Etikës UT] [Evidenca 3.31 Urdhër i Brendshëm i Rektorit Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt Rregullores për kontrollin antiplagjiaturë në UT]
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Secili pedagog përcakton syllabus-in e lëndës, ku brenda kornizave të lejuara nga kurrikula e programit të studimit, alternon metodat vlerësuese të cilat përfshijnë kontrollin e vazhdueshëm nëpërmjet provimeve, teste me pyetje/ alternativa, prezantime individuale/ grup etj. Diversiteti i formave të vlerësimit, i mundëson pedagogut të vlerësojë secilin student gjatë zhvillimit të lëndës. Teza e provimit, sipas rregullores së programit të studimit, merr në konsideratë nivele të ndryshme njohurish duke filluar nga konceptet bazë për përvetësimin e një lënde deri tek njohuritë më të përparura, dhe duke përcaktuar një vlerësim të drejtë për secilin student. Pas zhvillimit të provimit, rregullorja e programit të studimit përcakton që pas shpalljes së

	rezultateve studentëve i lejohet një afat dy ditor për rishikimin e tezës. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit/ rishikimit, pedagogët dorëzojnë në Departament, tezat e korrigjuara. [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 3.38 Sekretaria Mesimore]			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni garanton të drejtën e studentit për ankimim. Mbas shpalljes së rezultateve paraprake nga pedagogu, studenti ka të drejtë që brenda 48 orëve të bëjë ankesë tek pedagogu, i cili duhet t'i kthejë përgjigje dhe të sqarojë studentin në lidhje me notën. Nëse studenti nuk bindet për vlerësimin e marrë, i drejtohet Departamentit. [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit]			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo kërkesë apo ankimim shqyrtohet nga komisioni fillestar i provimit i përbërë nga dy persona. Nëse studenti nuk bindet për vlerësimin e marrë, brenda 48 orëve i drejtohet Departamentit. Ky i fundit propozon një komision i cili brenda 48 orëve miratohet nga Dekani. Në këtë rast ky komision i veçantë respekton rregulloren e programit të studimit dhe rregulloret e tjera që lidhen me procesin e provimeve në UT. [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit]			
Konkluzione	<i>Institucioni përmbush në mënyrë të plotë Standardin III.3, duke garantuar një proces vlerësimi të drejtë, transparent dhe të bazuar në meritë, i cili zhvillohet gjatë gjithë vitit akademik sipas strukturës së përcaktuar në syllabus. Përdoren platforma digjitale për të rritur transparencën dhe për të shmangur abuzimet. Studentët njihen me rezultatet, marrin feedback dhe kanë të drejtë ankimi, i cili shqyrtohet nga komisione të caktuara me procedura të dokumentuara. Masat kundër plagjiaturës respektohen, megjithëse mungon një soft antiplagjiaturë funksional. Në tërësi, institucioni siguron një proces të rregullt, të monitoruar dhe në përputhje me kuadrin ligjor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit zhvillohet në funksion të marrjes së njohurive të specializuara në një fushë të tillë siç është Matematika. Cikli i dytë i studimeve Master i Shkencave në Matematikë, ofron studentëve njohuri të thelluara teorike, praktike dhe profesionale. Përfitimi i këtyre aftësive është në fokus të procesit të mësimdhënies dhe nxënies duke punuar me

	studentët raste studimi, detyra në klasë, detyra në shtëpi ose detyra kursi në mënyrë individuale dhe në grup. Theks i veçantë është aktiviteti i të cilit përputhet me natyrën e programit të studimit, siç është kërkimi në matematikë teorike. Praktika në laboratorët e FSHN i jep mundësi studentit të avancojë njohuritë dhe aftësitë profesionale dhe të zhvillojë aftësitë individuale. Për këtë arsye orët e laboratorit dhe seminareve kanë një sasi të konsiderueshme orësh në auditor. [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 3.20 Detyre kursi] [Evidenca 4.10 Lista e Ambienteve të Departamentit] [Evidenca 4.11 Foto të laboratorit të Matematikës] [Tabela 13 ASCAL]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit Master i Shkencave në Matematikë është hartuar i tillë që studentët të cilët kanë përfunduar një cikël të parë studimi në programe të ngjashme, të marrin njohuri të avancuara teorike dhe praktike për veprimtari të ndryshme në fushën që parashikon programi. Nëpërmjet këtij programi studentët përforcojnë në disa njohuri themelore si: topologji dhe integrim, probabilitet dhe statistikë, ekuacione diferenciale. Në fushën specifike të programit të studimit studentët njihen me koncepte të avancuara në teori e lojrave, grupet dhe dinamikat topologjike, kriptografi, ekuacionet e fizikës matematike dhe machine learning. Studentët marrin njohuri dhe të koncepteve të menaxhimit dhe të projekteve, njohuri të cilat do mund të nevojiten në pozicione kyçe në kompani, si dhe koncepte të kërkimit shkencor të cilat mund t'iu nevojiten në ndjekjen e një cikli të tretë studimi. [Evidenca 2.2 Planet mesimore 21-24 shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.8 Faqe e procesverbalit nga mbledhja e DM për kurrikulen] [Evidenca 2.14 Çertifikata e akreditimit për programin Bachelor në Matematik, FSHN, UT]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Syllabuset e lëndëve rishikohen dhe pasurohen nga titullari i lëndës dhe grupet mesimore-kërkimore. Pedagogët mbështeten kryesisht në literaturë në gjuhën shqipe por edhe në gjuhën angleze për t'i ofruar studentëve një program lëndë sa më inovative. Gjatë zbatimit të syllabusit, pedagogët analizojnë pikat e forta dhe të dobëta të programit, si edhe nivelin e ndjekshmërisë të studentët. Në këtë mënyrë, në përfundimin e lëndës pedagogët analizojnë çështjet e ndryshme të cilat janë konstatuar gjatë trajtimit si të panevojshme apo të pa plotësuar dhe plotësohen duke synuar përsosjen e qëllimit të lëndës. Në Departament diskutohen çështje të ndryshme për përmirësimin në vazhdimësi të procesit mesimor dhe të syllabuseve. Në përfundim të leksioneve, secili pedagog zhvillon një seancë përmbyllëse, si një diskutim tërësor dhe përsëritje e të gjithë temave të realizuara gjatë lëndës. Studentët kanë mundësinë të bëjnë pyetje në lidhje me paqartësi të ndryshme që kanë për lëndën, si edhe pedagogu orienton drejt pjesëve më të rëndësishme

	për të përsëritur për provime. Krahas orëve mësimore, lektorët vënë në dispozicion orarin e pritjes ku i mundëson studentit takime individuale ose në grup për konsultime. [Evidenca 1.10 Rregulloret e Programi i Studimit] [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 2.11 Titullaret e grupeve mesimore-kerkimore] [Evidenca 3.44 Orari i konsultimeve me studentet]
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikën profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Leksionet dhe seminarët realizohen duke u bazuar në literaturë bazë të parashikuar në syllabuse, duke ju dhënë studentëve informacionet bazë. Laboratorët e FSHN mundësojnë një ambient të përshtatshëm për të vënë në zbatim të gjithë njohuritë teorike të përvetësuara. Studentët kanë mundësi që duke përdorur kompjuterat me parametra optimal të mund të ekzekutojnë dhe provojnë në kohë reale shembuj dhe projekte praktike. Gjithashtu, studentët mund të përdorin të gjithë pajisjet laboratorike për të zhvilluar të projekte të ndërlidhura me mësimin. Puna në grup është një element i rëndësishëm i procesit mësimor. Studentët inkurajohen për të punuar në grup edhe në zgjidhjen e detyrave të shtëpisë apo të kursit dhe gjatë procesit mësimor. Kjo punë realizohet nën drejtimin e pedagogut udhëheqës apo të lëndës, i cili motivon dhe inkurajon studentët për dhënie mendimi duke vënë në qendër studentin. Gjatë orës së seminarit, pedagogu angazhon në mënyrë të shpeshtë studentët, për të nxitur mendimin kritik dhe për ti shkathtësuar në zgjidhjen e problemeve të ndryshme të lidhura me fushë që studiohet. Duke mos pasur numër të lartë studentësh orët laboratorike zhvillohen në grupe të vogla, për të mundësuar një angazhim dhe bashkëpunim më të madh të studentëve. [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 3.8 Workshop i organizuar nga Departamenti i Matematikës FSHN] [Evidenca 3.19 Lista e programeve që kanë Detyrë Kursi] [Evidenca 3.20 Detyrë kursi] [Evidenca 4.11 Foto të laboratorit të Matematikës] [Tabela 9.13 ASCAL] Në strategjinë e UT dhe Planin strategjik të zhvillimit të programit përcaktohen qartë se procesi mësimor zhvillohet me në qendër studentin. Personeli akademik është i motivuar të komunikojë në mënyrë efektive me studentët, dhe i orientuar plotësisht nga studenti, i cili është aktor i rëndësishëm i procesit mësimor. Ai e luan këtë rol nëpërmjet studimit paraprak të materialit teorik dhe në leksionin e ardhshëm ai pozicionohet në pyetjet dhe zgjidhjen e atyre problemeve që nuk ka arrirë ti përvetësojë në shtëpi ose në mënyrë të pavarur. I gjithë ky proces monitorohet, ku një nga mënyrat është edhe pyetësori që bëhet në fund të lëndës me studentët. Format e mësimdhënies janë përsosur vazhdimisht në kushtet e UT, me qëllim që të rritet efektshmëria e mësimdhënies dhe e nxënies. Rritja e cilësisë së këtij procesi është bërë

	edhe si rezultat i bashkëpunimit me Universitete të huaja me të cilat FSHN ka bashkëpunim. UT dhe FSHN ka bashkëpunime me një numër të konsiderueshëm Universitetesh jashtë vendit. Si rrjedhojë e marrëveshje të vazhdueshme, stafi akademik dhe studentët kanë mundësi që të zhvillojnë vazhdimisht shkëmbime (program Erasmus+ etj.). [Evidenca 1.2 Strategjia e Zhvillimit UT] [Evidenca 1.5 Plani i zhvillimit strategjik të programit të studimit Msc në Matematikë] [Evidenca 2.28 Lista e mobiliteteve dhe pjesëmarrje në cost] [Evidenca 6.8 Raport për pyetsorin "Raport i Studentëve", 2021-2022 FSHN UT (2)]
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/ jashtë strukturës së programit të studimit.	Në fillim të vitit akademik, stafi i Fakultetit dhe Departamentit, propozojnë aktivitete të mundshme që mund të organizohen gjatë vitit. Në këto aktivitete përfshihen workshop-e nga personel i ftuar apo personel i brendshëm, seminare, projekte etj. Orët e hapura dhe seminarët organizohen në lidhje me tema bashkëkohore si fushën e inxhinierisë matematike dhe informatike. Seminarët zhvillohen në mënyrë interaktive, me synim inkurajimin e pjesëmarrjes së studentëve në diskutime, proces përmes të cilit ata arrijnë të qartësojnë dhe krijojnë ide, të bëjnë aplikime të ndryshme, të formulojnë dhe realizojnë ide, projekte dhe qëllime të caktuara. Kombinimi i dijes në auditor me punën e pavarur të studentit nëpërmjet detyrave të kursit individuale apo në grup mundësojnë përgatitjen e tyre me aftësi praktike dhe dije teorike afat gjatë. [Evidenca 2.22 Lista e disa prej studentëve] [Evidenca 3.15 Trajnimet "online" për personelin akademik] [Evidenca 3.24 Raport mbi analizen vjetore të Departamentit të Matematikës 2021-2022] [Evidenca 3.27 RAPORTI VJETOR FSHN UT 2023-2024]
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Për zhvillimin e temave të diplomës, studentët janë përfshirë në veprimtari shkencore me mbështetjen e stafit akademik. Gjithashtu, ata janë mbështetur në botimin e artikujve shkencorë në revista ndërkombëtare, me mbështetje financiare nga FSHN. [Evidenca 2.22 Lista e disa prej studentëve] [Evidenca 3.8 Workshop i organizuar nga Departamenti i Matematikës FSHN] [Evidenca 3.45 Certificate pjesëmarrje WORKSHOP] [Evidenca 3.46 Pjesëmarrje e studenteve në Konferencë me Temën e Diplomes]
Konkluzione	<i>Programi i studimit përmbush në shkallë të lartë kërkesat e standardit, duke garantuar thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale e shkencore të studentëve. Mësimdhënia mbështetet në punë praktike në laboratorë, punë në grup dhe metoda aktive me qendër</i>

	<i>studentin. Studentët përfshihen në kërkime, zhvillojnë projekte dhe tema diplome me mbështetje nga stafi dhe institucioni. Programi nxit aftësitë në teknologji, komunikim dhe gjuhë të huaj, dhe siguron përmirësim të vazhdueshëm të syllabusit. Realizohen orë të hapura, seminare shkencore dhe bashkëpunime ndërkombëtare që rrisin cilësinë dhe mobilitetin. Studentët mbështeten edhe financiarisht për ide inovative dhe botime shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Në programin e studimit është përcaktuar qartë që studentët gjatë semestrit të fundit të programit të studimit duhet të zhvillojnë një punim diplomë. Procedura dhe detyrimet përmbyllëse janë të përcaktuara në Rregulloren e Programit të Studimit dhe në Rregulloren e Diplomimit dhe janë publike në website e FSHN. Në fillim të semestrit të parë, studenti duke u bashkërenduar me udhëheqësin e diplomës caktojnë temën dhe hapat për realizimin e saj. Çdo student i komunikon Departamentit lektorin me të cilin zhvillon punimin e diplomës. [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 3.39 Lista e temave të diplomave] [Evidenca 3.47 Rregullore e Diplomimit]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik angazhohen për të vënë në dispozicion të studentëve informacione dhe materialet përkatëse në shërbim të tezës së diplomës. Përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me këshilltarët akademik asistojnë studentët në zgjedhjen e fushës së studimit, temës që do të hartohet dhe pedagogut udhëheqës. [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 2.15 Lista e kujdestareve për studentet e çdo viti Programi Master Shkencor në Matematikë] [Evidenca 3.47 Rregullore e Diplomimit]
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi përfundimtar bëhet me mbrojtjen e një mikroteze të zgjedhur nga studentët në bashkëpunim me pedagogët udhëheqës. Këto tema përfshijnë të gjitha grup lëndët e programit. Mbrojtja e tezës dhe vlerësimi i studentit bazohen në rregulloren e diplomimit. [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 3.47 Rregullore e Diplomimit]

Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbys sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në fillim të vitit të dytë studentët zgjedhin pedagogun udhëheqës ku i ofron disa tema kërkimore për të zgjedhur temën përkatëse të diplomës. Gjatë semestrit të fundit (semestri i katërt) vijon puna hap pas hapi nga ana e studentit nën mbikëqyrjen e pedagogut udhëheqës. Udhëheqësi i temës së diplomës udhëzon studentët përmes procesit të kryerjes së hulumtimit dhe shkrimit të punimit të diplomës së tyre, siç përcaktohet në Rregulloren e Diplomimit. Udhëheqësi i punimit të diplomës përcakton një problem të përshtatshëm për studentin dhe më pas e drejton atë: i) të kuptojë problemin, ii) ndihmon për të identifikuar gjendjen e problemit që është në dispozicion, iii) për të përcaktuar një qasje për të zgjidhur problemin, iv) për të zgjidhur dhe raportuar në një mënyrë të përshtatshme. Është udhëheqësi i punimit të diplomës që vlerëson nëse punimi mund të paraqitet përpara komisionit apo jo. [Evidenca 3.39 Lista e temave të diplomave] [Evidenca 3.47 Rregullore e Diplomimit]
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në Rregulloren e Diplomimit janë përcaktuar me hollësi përgjegjësitë e institucionit dhe udhëheqësit të diplomës ku parashikohen edhe ndihma në përzgjedhjen dhe implementimin e metodologjisë së studimit. Departamenti i Matematikës ka laboratorin e kërkimit shkencor që përdoret në kryerjen e analizës dhe përpunimit të të dhënave. [Evidenca 3.47 Rregullore e Diplomimit] [Evidenca 4.10 Lista e Ambienteve të Departamentit] [Evidenca 4.11 Foto të laboratorit të Matematikës]
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Studentët vlerësohen me notë në përfundim të mbrojtjes së diplomës. Mënyra e vlerësimit për studentet që realizojnë mbrojtjen e diplomës me teme, operohet me sistemin e notës. Kështu, secili pedagog pjesë e komisionit dëgjon prezantim të temës nga studentet, i drejton pyetje dhe e vlerëson me notë. Në fund komisioni mbledhet dhe përdor sistemin e mesatarizimit të notës. Mesatarja e këtyre notave përcakton edhe notën përfundimtare të studentit në mbrojtjen e temës së diplomës. [Evidenca 1.10 Rregullore e Programit të Studimit] [Evidenca 3.47 Rregullore e Diplomimit]
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në bazë të nenit 91, të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar sipas dispozitave ligjore në fuqi. [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 2.9 Model i diplomes dhe suplementit Master Shkencor në Matematikë] [Evidenca 3.38 Sekretaria Mesimore]
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të	Institucioni ruan përgjatë viteve të studimit kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Me pas studentët, në mbyllje të studimit, kanë

studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	të drejtë të tërheqin dokumentacionin personal. Këto të dhëna janë të regjistruara dhe te ruajtura pranë Sekretarisë Mësimore dhe përbëjnë regjistrin themeltar. Të dhënat bazë i dërgohen Qendrës së Shërbimeve Arsimore. Dokumentacioni i regjistrave të diplomimit të studentëve dhe performanca e lëndëve ruhet nga Sekretaria Mësimore. [Evidenca 3.36 Regjistri themeltar të studentëve] [Evidenca 3.37 Regjistri i arritjeve akademike] [Evidenca 3.38 Sekretaria Mesimore]			
Konkluzione	<i>Programi i studimit përmbush në mënyrë të plotë kërkesat e Standardit. Institucioni ka procedura të qarta dhe publike për detyrimet përmbyllëse të studentëve, të pasqyruara në rregullore dhe të publikuara në faqen zyrtare. Studentët asistohen nga strukturat përgjegjëse dhe udhëheqësit akademik në të gjitha fazat e përgatitjes së temës së diplomës, që nga përzgjedhja e temës deri te shkrimi dhe mbrojtja. Mbrojtja e punimit vlerësohet me notë nga një komision, sipas një procedure të përcaktuar. Institucioni siguron mjedise laboratorike për zhvillimin e temës dhe ndihmon në analizat e nevojshme. Në përfundim, studentët pajisen me diplomë dhe suplementin përkatës, ndërsa dokumentacioni i tyre ruhet në përputhje me ligjin.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6 Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk aplikohet për këtë program studimi
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk aplikohet për këtë program studimi

Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nuk aplikohet për këtë program studimi			
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/ moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Nga dokumentacioni i paraqitur dhe takimet e zhvilluara me stafin, u konstatua se personeli akademik zotëron kualifikimet e nevojshme, në përputhje me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë. Shumica e pedagogëve mbajnë gradën shkencore "Doktor" ose i përkasin kategorisë "Profesor" dhe disponojnë eksperiencën e duhur akademike dhe shkencore. Personeli akademik është i përzgjedhur në mënyrë të tillë që të mbulojë fushat përkatëse të programit të studimit. GVJ vëren se personeli akademik efektiv dhe me kontratë i Departamentit të Matematikës ka një përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor dhe është i kualifikuar për drejtimin e programit, si dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve mësimore të programit. Përbërja aktuale e stafit akademik përfshin 15 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët 3 janë Profesorë Doktorë, 7 Profesorë të Asociuar dhe 5 mbajnë gradën Doktor. Gjithashtu, janë të angazhuar 8 pedagogë me kohë të pjesshme: 1 Profesor Doktor, 1 Profesor i Asociuar, 2 me gradën Doktor, 1 në proces doktoreture dhe 3 me diplomë MSc. Kjo strukturë tregon një diversitet kualifikimesh dhe një ekuilibër të mirë midis përvojës akademike dhe potencialit për zhvillim të mëtejshëm. Departamenti i Matematikës ofron fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e lëndëve të tij. [Evidencat 1.7 Personeli akademik i Departamentit të Matematikës dhe kualifikimi i tij] [Evidenca 1.12 STRATEGJIA KOMBËTARE E ARSIMIT 2021-2026] [Evidenca 1.5 Plani i Zhvillimit Strategjik i Programit të Studimit MSc në Matematikë] [Evidenca 3.24 Raport mbi analizen vjetore të Departamentit të Matematikës 2021-2022] [Evidenca 3.25 Raportet 22-23] [Evidenca 3.27 RAPORTI VJETOR FSHN UT 2023-2024] [Evidenca 3.39 Lista e temave të diplomave.]
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i planeve të ngarkesës akademike për çdo pedagog, u konstatua se personeli akademik efektiv mbulon të gjitha lëndët dhe modulet e programit të studimit në përputhje me kërkesat ligjore. Numri i pedagogëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm është i organizuar në mënyrë të tillë që të sigurohet realizimi i plotë i ngarkesës akademike, duke respektuar standardet e përcaktuara nga ligji për arsimin e lartë dhe

	aktet nënligjore mbështetëse. Nga hulumtimi ynë rezulton se stafi akademik me kohë të plotë mbulon për vitin akademik 2022-2023 mbi 95% të ngarkesës mësimore (616 orë PAE dhe 30 orë PAK). Për vitin akademik 2023-2024 stafi akademik me kohë të plotë mbulon mbi 95 % të ngarkesës mësimore (619 PAE dhe 30 PAK). Përveç angazhimit në procesin mësimor, pedagogët janë të përfshirë në veprimtari të tjera akademike, si mentorimi i studentëve dhe pjesëmarrja në projekte kërkimore. Vlerësohet se këto angazhime nuk kanë ndikuar negativisht në cilësinë e mësimdhënies. [Evidenca 4.2 Model Ngarkese e Departamentit të Matematikës] [Tabelat ASCAL]
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit përkatës dhe në kontaktet me personat përgjegjës, është konstatuar se personeli akademik efektiv, personeli akademik me kontratë dhe personeli ndihmës akademik i angazhuar në të gjitha programet e studimit pranë Departamentit të Matematikës kanë kontrata punësimi dhe mbulim me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Këto dokumente përcaktojnë qartë detyrimet dhe të drejtat e personelit akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kontratat janë të vlefshme për periudha të përshtatshme kohore, duke garantuar vazhdimësinë e procesit akademik. [Evidenca 4.3 Procedure punesimi per PE] [Evidenca 4.4 Model vertetim page] [Evidenca 4.5 Procedure punesimi]
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedura për rekrutimin e stafit përmban të gjitha hallkat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Përgjegjëse për këtë janë Sektori i Burimeve Njerezore dhe Sektori Protokoll – Arshivë i UT në bashkëpunim me Njesinë Baze (Dega e Burimeve Njerezore dhe Protokoll -Arshive të FSHN). Pozicionet e lira bëhen publike në faqen e internetit të IAL. Pasi bëhet shpallja dhe merren në dorëzim dosjet e aplikantëve, ngrihet komisioni përkatës. Kandidatet klasifikohen sipas pikëve të fituara nga dokumentacioni i paraqitur dhe nga intervista e bere nga komisioni perkates. GVJ gjykon që proceduara e rekrutimit të stafit garanton rekrutimin e personelit në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e Programit të Studimit. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 4.3 Procedure punesimi per PE] [Evidenca 4.6 Struktura organizative UT]
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e	Në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar dhe takimeve në Departament, rezulton se në Departamentin e Matematikës ka vetëm një staf ndihmës akademik, i cili zotëron kualifikimin e nevojshëm për të përmbushur detyrat që i takojnë në bazë të ligjit për pozicionin e punës që ai ka, si dhe detyrat që i ngarkohen nga personat përgjegjës të Departamentit.

laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Meqenëse numri i studentëve është i kufizuar në këtë Departament, mendojmë se për momentin ky staf është i mjaftueshëm, por duhet të merret në konsideratë perspektiva e rritjes së numrit të studentëve, si edhe zgjerimi i veprimtarive akademike dhe shkencore të Departamentit, përfshirë edhe shërbimet ndaj të tretëve. <i>Kjo mund të kërkojë në të ardhmen rritjen e numrit të stafit ndihmës, çka duhet të kihet në konsideratë nga drejtuesit e Departamentit.</i> [Evidenca 2.13 CV shqip dhe anglisht Programi Master] [Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Matematikës] [Evidenca 4.13 Infrastruktura, kapacitete FSHN]
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Në bazë të dokumentacionit të hulumtuar si dhe verifikimeve të bëra nga GVJ, rezulton se në FSHN, ku bën pjesë edhe Departamenti i Matematikës, strukturat përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit janë Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll-Arkivës. Kjo kryhet në bazë të rregulloreve përkatëse të brendshme si dhe sipas udhëzimeve të MASR. Ruajtja dhe përditësimi i këtyre të dhënave realizohet në dosjet përkatëse të personelit. Gjatë shqyrtimit të dosjeve nga GVJ u vërejt se të dhënat personale të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe ato të personelit ndihmës, përmbanin të gjitha të dhënat e kërkuara dhe ishin të përditësuara për çdo vit akademik. [Evidenca 4.2 Model Ngarkese e Departamentit të Matematikës] [Evidenca 2.13 CV shqip dhe anglisht Programi Master]
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Referuar dokumentave të depozituara dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ ka konstatuar se në Departamentin e Matematikës, ekziston hapësira e nevojshme akademike dhe materiale për menaxhimin e aktiviteteve të ndryshme për studentet, sic janë praktikat profesionale apo diplomat. GVJ konstaton se në përgjithësi janë pedagogët dhe stafi ndihmës i Departamentit ata që menaxhojnë udhëheqjen e diplomave, duke pasur parasysh karakterin e profilit të diplomës përkatëse. Megjithatë, studenteve u sigurohet edhe pjesëmarrje në intership- e të ndryshme, nëpërmjet kontratave të sigururara nga Fakulteti. GVJ ka konstatuar se janë të angazhuar personel i mjaftueshëm dhe të kualifikuar për të mbështetur studentët në përmbushjen e kërkesave realizimit të diplomës dhe aktiviteteve të tjera që lidhen me natyrën e programit të studimit. [Evidenca 4.10 Lista e Ambienteve të Departamentit] [Evidenca 4.11 Foto të laboratorit të Matematikës] [Evidenca 4.12 Foto të pajisjeve audio vizive të departamentit] [Evidenca 4.13 Infrastruktura, kapacitete FSHN] [Evidenca 4.15 tabela me formule student-pedagog për m2] [Evidenca 1.8 Marrëveshjet e FSHN]

Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve / raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ konstaton se ky kriter aplikohet për programin e studimit “Master Profesional”.			
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni, FSHN/UT, ku ben pjese edhe Departamenti i Matematikës, angazhohet në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të stafit akademik dhe atij ndihmës, në përputhje me qëllimet dhe objektivat e vena dhe programin e studimit, për tu paraprirë zhvillimeve të reja të teknologjive dhe mundësisë së rekrutimit të një numri më të madh të rinjsh në këto degë. Institucioni ka zhvilluar procedura të qarta për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave personale të personelit akademik dhe atij ndihmës, në përputhje me rregulloret e institucionit. Gjithashtu, procedurat e rekrutimit të personelit janë realizuar në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi, duke siguruar një mjedis akademik të qëndrueshëm dhe cilësor për studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ konstaton se, bazuar në RVB, dokumentacionin e vënë në dispozicion, si dhe vizitën e kryer në institucion, UT dhe konkretisht FSHN/ Departamenti i Matematikës, ofron ambiente të mjaftueshme dhe shumë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimdhënës, duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe specifikën e programit të studimit. Auditoret, laboratorët dhe mjediset ndihmëse rezultuan të gjitha funksionale. FSHN disponon ambiente me hapësira të mjaftueshme e të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore teorike, praktike dhe laboratorike. GVJ konstaton se plotësohen standardet dhe normativat sipas VKM për infrastrukturën e një IAL. [Evidenca 1.6 Organigrama e FSHN] [Evidenca 4.10 Lista e Ambienteve të Departamentit] [Evidenca 4.13 Infrastruktura, kapacitete FSHN]

	[Evidenca 4.14 Kuotat e ciklit te pare, te dyte 2023-2024] [Evidenca 4.15 tabela me formule student-pedagog per m2]
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies- mësimnxënies.	Në të gjitha ambientet mësimore të institucionit, të vizituara nga GJV, u vu re se klasat ku zhvillohej mësimi ishin të pajisura me dërrasa të zakonshme me shkumës, projektorë video, kompjuter dhe internet, të cilat ishin funksionale. Gjithashtu, në Laboratorin e Departamentit të Matematikës gjendeshin të gjitha mjetet e nevojshme për zhvillimin e seancave laboratorike dhe demonstrimin e procedurave sipas planit mësimor. Mjetet audiovizuale ishin të instaluar në mënyrë të përhershme vetëm në dy nga katër godinat. Sugjerohet që kjo praktikë të shtrihet në të gjitha godinat ku zhvillohet mësim. Personeli akademik dhe studentët kishin mundësi të shfrytëzonin Sistemin Digjital të Unifikuar Microsoft Teams. [Evidenca 3.1 Udhezues i UT për mesimin në distance f2c2b81980] [Evidenca 3.2 Rregullore e UT mbi zhvillimin të provimeve online] [Evidenca 3.3 Manual për përdorimin e platformës Microsoft Teams]
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ, nëpërmjet vizitës në institucion, konstaton se Departamenti i Matematikës disponon një laborator që shërben për realizimin e detyrave të kursit për studentët e Masterit, si dhe për punimet e diplomës. Ky laborator vlerësohet i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve studentore. [Evidenca 4.10 Lista e Ambienteve te Departamentit] [Evidenca 4.11 Foto te labororit te Matematikes] [Evidenca 4.13 Infrastruktura, kapacitete FSHN]
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ, nëpërmjet vizitës në institucion vëren se Programi i Studimit Master i Shkencave në Matematikë garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit nëpërmjet labororit të dedikuar për këtë qëllim, i cili përmbante 15 kompjutera, 1 cisco lab, 1 tabelë smartboard, 15 makina llogaritëse shkencore, 1 dron dhe 4 raspberry, me synimin që këto sisteme të ripërtërihen herë pas here. [Evidenca 3.10 Projekti PIKSH] [Evidenca 4.11 Foto te labororit te Matematikes]
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të	GVJ konstaton se ky kriter aplikohet për programin e studimit "Master Profesional". Megjithatë, GJV, nëpërmjet dokumentacionit të prezantuar dhe takimeve me personat përgjegjës në Institucion, vëren se FSHN ka marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera, përfaqësues biznesi e kompani, për t'u ofruar studentëve mundësinë të kryejnë internship-e, seminare etj. [Evidenca 1.8 Marrëveshjet e FSHN] [Evidenca 1.9 Marrëveshjet me UT]

tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.				
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni (konkretisht DM/FSHN si pjesë e UT) ofron ambiente të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, me hapësira të bollshme dhe të pajisura me teknologji të përshtatshme informatike. Laboratorët dhe auditoret janë funksionale dhe të pajisura me aparaturat dhe softuerët e nevojshëm për zhvillimin e mësimin praktik dhe teorik. Infrastrukturat e dedikuara për çdo program studimi mundësojnë një proces akademik me standarte të larta. Kjo siguron një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e kompetencave të studentëve dhe përmbushjen e kërkesave të programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Nga verifikimet e bëra nëpërmjet dokumentacionit dhe në Institucion, GVJ vëren se Programet e lëndëve (sillabuset) përmbajnë informacionin e nevojshëm në lidhje me literaturën e detyruar (literatura bazë) dhe atë të rekomanduar (literatura ndihmëse). Literatura bazë e programit Master i Shkencave në Matematikë, në përgjithësi, ishte në gjuhën shqipe dhe vihej në dispozicion të studentëve si tekst mësimor ose leksione të shkruara nga pedagogët e lëndëve përkatëse. Studentët kishin mundësi, nëpërmjet sistemit Microsoft Teams, të aksesonin literaturë në formë elektronike. Po kështu, UT dhe FSHN ofronin bibliotekë online edhe për studentët e këtij Masteri. [Evidenca 4.17 lista e teksteve në bibliotekë] [Evidenca 4.18 Revista periodike e FSHN] [Evidenca 4.19 Fondi i Bibliotekës FSHN]
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ konstaton se për studentët e këtij Masteri Shkencor, literatura bazë ofrohet në formën e teksteve mësimore, të cilat janë ribotime të viteve të fundit, ose si cikël leksionesh të përditësuar. Pedagogët siguronin që studentët të kishin mundësinë e aksesit në publikime të përvitshme, artikuj e monografi, në lidhje me programin mësimor. [Evidenca 2.19 Kërkes dhe vendim për ndryshim mbi planet mësimore] [Evidenca 4.17 lista e teksteve në bibliotekë]

	[Evidenca 3.24 Raport mbi analizen vjetore te Departamentit te Matematikes 2021-2022] [Evidenca 3.25 Raportet 22-23] [Evidenca 3.26 Shkresa e Raporti vjetor 2022-2023] [Evidenca 3.27 RAPORTI VJETOR FSHN UT 2023-2024] [Evidenca 4.17 lista e teksteve ne biblioteke] [Evidenca 4.18 Revista periodike e FSHN] [Evidenca 4.20 Rregullore e brendshme e bibliotekës të FSHN]
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL, si dhe nga verifikimet e bëra në Institucion, GVJ vëren se Fakulteti i Shkencave të Natyrës, ku bën pjesë edhe Departamenti i Matematikës, zotëron një bibliotekë me një fond të konsiderueshëm materialesh mësimore dhe shkencore, të akumuluar për dhjetra vite. Kishte hapësirën e nevojshme për punë të studentëve dhe burime informacioni të larmishme, duke ofruar shërbimin print dhe online. Në këtë bibliotekë gjendeshin kopje të diplomave të doktoratave të pedagogëve ndër vite, si dhe të revistës shkencore të fakultetit. [Evidenca 4.19 Fondi i Bibliotekes FSHN] [Evidenca 4.20 Rregullore e brendshme e bibliotekës të FSHN] [Evidenca 4.21 Buxheti FSHN 2021]
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e FSHN ofron literaturën fizike të nevojshme për mbulimin e të gjitha programeve të studimit që ofron fakulteti, përfshirë edhe atë të programit Master i Shkencave në Matematikë. Fondi i ofruar është i përbërë nga 80,018 tituj. Prej tyre, 36,600 njësi janë libra e monografi shkencore (1,158 në shqip, 35,443 në gjuhë të huaj), 896 njësi disertacione (858 në shqip, 38 në gjuhë të huaj) dhe 24,451 njësi revista e periodikë shkencorë (64 shqip dhe 24,387 në gjuhë të huaj). Nuk kemi informacion mbi efikasitetin e përdorimit të këtij materiali nga studentët e këtij Masteri Shkencor në Matematikë. [Evidenca 4.19 Fondi i Bibliotekes FSHN] [Evidenca 4.20 Rregullore e brendshme e bibliotekës të FSHN]
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga hulumtimi dhe takimet e realizuara nga GVJ rezulton se studentët e Masterit Shkencor në Matematikë, si pjesë e UT/ FSHN, kanë akses në burimet e bibliotekave online, pa pagesë. UT (pra edhe FSHN/ Departamenti i Matematikës) ka finalizuar marrëveshje për qasje edhe në biblioteka të tjera dixhitale si JSTOR, ELGAR, IOP, ASTM, MSP. Aksesin në to mund të realizohet përmes faqes online të UT (www.unitir.edu.al) dhe FSHN (www.fshn.edu.al), duke shfrytëzuar adresën zyrtare të e-mail-it të mundësuar nga Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Biblioteka e FSHN ishte në proces digjitalizimi. [Evidenca 4.19 Fondi i Bibliotekes FSHN] [Tabela 17 ASCAL; www.fshn.edu.al]

Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ, gjatë vizitës në ambientet e Bibliotekës së FSHN dhe takimeve me personat përgjegjës, konstaton se në bibliotekën e FSHN, në dispozicion të studentëve janë vendosur kompjutera me akses në internet dhe burimet online të vendosura në fondet e hapura. Kompjuterat janë të pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. Ndërkohë, Departamenti i Matematikës u ofronte studentëve mundësinë të përdorin edhe kompjuterat e laboratorit të Matematikës. [Evidenca 3.10 Projekti PIKSH] [Evidenca 4.11 Foto te laboratorit te Matematikes] [Evidenca 4.19 Fondi i Bibliotekes FSHN]
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se biblioteka e Fakultetit të Shkencave të Natyrës ofron orare shërbimi të përshtatshme për studentët, të cilat janë në përputhje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe ofrojnë mundësi të gjera shfrytëzimi. Ky shërbim fleksibël siguron që studentët të kenë mundësi të plotë për akses në burimet bibliografike, print dhe online, të nevojshme për studimet e tyre. [Evidenca 4.20 Rregullore e brendshme e bibliotekës të FSHN]
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Në bazë të dokumentacionit të ofruar, si dhe nga verifikimet e bëra gjatë vizitës në Institucion (FSHN), GVJ vëren se Universiteti i Tiranës/ Fakulteti i Shkencave të Natyrës i ka kushtuar vëmendje rinovimit të ambienteve, si dhe pajisjeve dhe pasurimit të fondit të literaturës së bibliotekës. Kjo është bërë duke marrë në konsideratë kërkesat e njësive bazë në lidhje me nevojat për fondin e bibliotekës, duke përfshirë këtu edhe ato të Departamentit të Matematikës, në mbështetje të programit të studimit. Megjithatë, sugjerojmë që të rritet buxheti i parashikuar për pasurimin e fondit të bibliotekës me literaturë të përshtatshme dhe me burimet online për akses në web-et e kërkimit shkencor. [Evidenca 4.21 Buxheti FSHN 2021] [Evidenca 4.22 Buxheti FSHN 2022] [Evidenca 4.23 Buxheti FSHN 2023] [Evidenca 4.24 Buxheti FSHN 2024]
Konkluzione	<i>GVJ vëren se Fakulteti i Shkencave të Natyrës/ Universiteti i Tiranës, ku Departamenti i Matematikës është pjesë, ka krijuar kushte të përshtatshme për shfrytëzimin e bibliotekës dhe burimeve akademike nga studentët, duke siguruar akses të barabartë dhe pa pagesë në fondet fizike dhe online. Biblioteka është e pajisur me fond mësimor dhe kërkimor të pasur, si në formën print ashtu edhe në atë online. Ajo ofron orare shërbimi të përshtatshme, duke përmbushur nevojat e studentëve</i>

	dhe të personelit akademik. GVJ rekomandon rritjen e buxhetit për pasurimin e fondit të bibliotekës, por, ndërkohë, sugjeron të vazhdojë puna për dixhitalizimin e plotë të fondit ekzistues të kësaj biblioteke si një pasuri me vlera kombëtare, duke pasur parasysh historikun e FSHN.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstaton se në Fakultetin e Shkencave të Natyrës/UT ekziston sistemi i menaxhimit të dokumentacionit mësimor dhe baza e të dhënave të studentëve, veprimtaria e të cilit bazohet te aktet ligjore dhe Rregullorja e Universitetit të Tiranës. Sekretaria mësimore e FSHN i mban këto informacione në formë të shkruar dhe ruhen në kasafortën e sekretarisë mësimore: • Regjistrin themeltar të studentëve • Regjistrin e arritjeve akademike të studentëve • Regjistrin e lëshimit të diplomave Çdo anëtar i stafit dhe çdo student ka adresën e vet të e-mail-it, të cilën mund ta aksesojë në çdo kohë, brenda dhe jashtë universitetit, për të marrë informacionin e kërkuar që lidhet me të dhënat personale, rezultatet e provimeve sipas semestrave apo viteve akademike, si dhe të dhëna të tjera didaktike. [Evidenca 1.5 Plani i zhvillimit strategjik të programit të studimit Msc në Matematikë] [Evidenca 3.36 Regjistri themeltar të studentëve] [Evidenca 3.37 Regjistri i arritjeve akademike] [Evidenca 3.42 UT Kerkim Ekselence dhe Inovacion]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ konstatoi se në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, menaxhimi i informacionit dhe i dokumentacionit, si dhe aktiviteti i personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit të pedagogëve, realizohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore/Sektori Protokoll- Arshives dhe nga Dega e Burimeve Njerëzore dhe Dega e Protokoll- Arshives. [Evidenca 1.6 Organigrama e FSHN] [Evidenca 4.28 Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës] [Evidenca 4.3 Procedure punesimi për PE]

	[Evidenca 4.5.3 Rregullore e Burimeve Njerëzore (Manual mbi punësimin e personelit në Universitetin e Tiranës)] [Evidenca 4.5.4 Format i dosjes PAE] [Evidenca 4.5 Procedure punesimi PAK]
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ vëren se në FSHN, sistemi i menaxhimit të informacionit siguron studentëve, personelit akademik dhe ndihmës akademik një akses tërësisht të dedikuar dhe konfidencial, si dhe ruajtje të të dhënave personale. Aksesit sigurohet nëpërmjet një portali të pajisur me llogari personale të stafit dhe studentëve. Nëpërmjet këtij portali, të interesuarit mund të marrin informacionet e nevojshme dhe të printojnë fatura në lidhje me aktivitetin mësimor. Për një informacion më të shpejtë në lidhje me rezultatet e provimeve, rekomandohet përdorimi i sistemit online të hedhjes së rezultateve nga ana e vet pedagogëve të lëndëve. Kjo do të mundësonte marrjen e informacionit nga studentët në kohë reale. Ky sistem duhet të jetë pjesë integrale e sistemit të menaxhimit të të dhënave të fakultetit. [Evidenca 3.16 Komunikim ne Teams me studentet.] [Evidenca 4.29 Informacion portal e-student 1]
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konfirmon se UT/ FSHN ka vënë në përdorim platformën e dedikuar, Microsoft Teams, si dhe portalin e studentëve dhe pedagogëve, që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. [Evidenca 3.16 Komunikim ne Teams me studentet] [Evidenca 4.19 Fondi i Bibliotekes FSHN]
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ vëren se FSHN (çka nënkupton edhe Departamenti i Matematikës) ka në funksionim sistemin personal të menaxhimit të llogarive, platformën dixhitale Teams, si dhe faqet zyrtare (www.unitir.edu.al dhe www.fshn.edu.al). Nëpërmjet tyre garantohej në kohë reale aktiviteti akademik dhe administrativ i personelit akademik, ndihmës akademik, raportimet individuale dhe të dhënat mbi organet drejtuese. Ky sistem ofron mundësi për ndarjen e materialeve mësimore, mbështetje të menjëhershme për pyetje dhe diskutime, si dhe monitorimin e përparimit të studentëve në mënyrë të efektshme. Platforma të tilla sigurojnë një komunikim të lehtë dhe efikas, duke përmirësuar procesin mësimor dhe administrativ. [Evidenca 3.16 Komunikim ne Teams me studentet] [Evidenca 3.18 Komunikimi ne email me studentet]
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë,	GVJ konstatoi se FSHN/UT publikon informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në faqen e tij të internetit, në gjuhën shqipe dhe anglisht. Ky informacion është i aksesueshëm për studentët dhe palët e interesuara, duke siguruar transparencë dhe mundësi të barabarta për të gjithë përdoruesit. Kjo

ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	mundëson një komunikim efikas dhe mbështet zhvillimin e një mjedisi akademik të hapur dhe ndërkombëtar. [Evidenca 4.28 Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës] [evidenca 4.29 Informacion portal e-student 1]			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se Institucioni ka krijuar një mjedis efikas dhe të qartë për komunikimin dhe shpërndarjen e informacionit. Sistemi i menaxhimit mundëson komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni të lehtë ndërmjet personelit akademik dhe studentëve, duke përmirësuar procesin mësimor. Informacionet lidhur me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme janë të disponueshme në faqen e internetit në gjuhën shqipe dhe anglisht, duke siguruar akses të barabartë dhe transparencë për të gjithë përdoruesit. Rekomandohet përdorimi i platformës online nga pedagogët edhe për menaxhimin e aktivitetit të studentëve gjatë semestrit në lëndë apo module përkatëse. Kjo do të bënte sistemin e vlerësimit të studentëve më transparent.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton se Institucioni (UT/ FSHN dhe Departamenti i Matematikës si pjesë e këtij institucioni) harton një raport financiar të detajuar për kostot e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit. Ky raport përfshin një analizë të shpenzimeve dhe burimeve financiare të nevojshme për mbështetjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. Po ashtu, institucioni ka një plan të strukturuar për mbështetje financiare, duke siguruar që të gjithë resurset e nevojshme për realizimin e programeve të studimit janë të siguruar dhe të menaxhuara në mënyrë efikase. Kjo masë garanton vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e programeve të studimit që ofrohen në afat të gjatë. [Evidenca 4.22 Buxheti FSHN 2022] [Evidenca 4.23 Buxheti FSHN 2023] [Evidenca 4.24 Buxheti FSHN 2024] [Evidenca 4.31 Raporti financiar i kostos së programeve]

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua edhe lidhur me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse dhe të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. Burimi kryesor i financimit janë të ardhurat nga grantet mësimdhënie, të ardhurat nga UT si shërbime ndaj të tretëve, tarifat e studentëve, ndërsa fondet e tjera lidhen me të ardhurat nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, por që janë në një përqindje shumë të vogël. Departamenti i Matematikës ka një kontribut shumë të vogël në këtë rast. Shpërndarja e këtyre fondeve bëhet me miratim nga Bordi i Administrimit i UT Evidenca 4.21 Buxheti FSHN 2021]
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	[Evidenca 4.22 Buxheti FSHN 2022] Nga dokumentacioni i disponueshëm, si dhe vizita në institucionin e FSHN, GVJ konstaton se UT/ FSHN kryen audit të brendshëm institucional, si dhe audit të jashtëm nga institucionet përgjegjëse, si KLSH dhe Auditi i Ministrisë përgjegjëse. [Evidenca 4.26 Urdhër Nr. 08 datë 30.08.2021 Mbi miratimin e Programit të Transparencës së Rishikuar në UT]
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ, në bazë të dokumentacionit që disponon dhe takimeve me personat përgjegjës në Fakultet, vëren se Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar. Raportet dhe analizat përshkruajnë periudhat për vitin në vijim dhe të viteve të kaluara akademike. Planifikimet dhe ndërhyrjet e posaçme parashikohen në buxhetet afatmesme për garantimin dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit. [Evidenca 4.26 Urdhër Nr. 08 datë 30.08.2021 Mbi miratimin e Programit të Transparencës së Rishikuar në UT] [Evidenca 4.33 Vendim Për miratimin paraprak të programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe 2022-2024 për UT]
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Bazuar në dokumentacionin që disponon, si dhe takimeve të kryera në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, GVJ konstaton se Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve, në këtë rast të Masterit Shkencor në Matematikë. Nga dokumentat që disponojmë, vërejmë se UT ka burime financiare të mjaftueshme për të siguruar qëndrueshmërinë e zhvillimit të programit mësimor në fjalë. [Tabela 18 ASCAL]

Konkluzione	GVJ vëren se Fakulteti i Shkencave të Natyrës/UT, ku Departamenti i Matematikës është pjesë integrale e tij, ka një sistem të mirëstrukturuar financiar që mbështet programet e studimit dhe siguron kushte të përshtatshme infrastrukturore dhe akademike. Planifikimi i detajuar i kostove dhe mundësive të mbështetjes financiare siguron realizimin e procesit mësimor dhe përbushjen e nevojave të programeve të studimit për një cikël të plotë. Pasqyrat financiare dhe auditimet vjetore dëshmojnë një gjendje të qëndrueshme financiare, e cila ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe infrastrukturës së universitetit.			
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ, nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në Fakultet/ Departamenti i Matematikës, konstaton se Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i Matematikës harton dhe zbaton politika dhe procedura të qarta që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, nga hyrja deri në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. Këto procedura përfshijnë proceset e pranimit, përzgjedhjes, përparimit, transferimit, njohjes dhe vlerësimit të dijeve, si dhe diplomimit të studentëve. Kjo bën të mundur që të gjithë studentët të trajtohen në përputhje me standardet ligjore dhe akademike. (Statuti i Universitetit të Tiranës: kreu VII dhe IX i dedikohen plotësisht studentit dhe organizimit të studimeve; Strategjia e UT dhe Rregullorja e UT: kreu V dhe VII i dedikohen plotësisht studentit dhe organizimit të studimeve.) [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.2 Strategjia e Zhvillimit UT] [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Matematikës.] [Evidenca 2.9 Model i diplomes dhe suplementit Master Shkencor në Matematikë] [Evidenca 3.47 Rregullore e Diplomimit] [Evidenca 5.2 Miratim komisioni ad-hoc për deget e dyta dhe transferimet] [Evidenca 5.3 2021-2022.; Evidenca 5.3 Kuotat 22-23; Evidenca 5.3 Kuotat e pranimit MSH]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se, bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Institucioni ka ndërtuar bazën ligjore të domosdoshme përsa u përket procedurave dhe politikave që garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë gjatë gjithë periudhës së ndjekjes së programit të studimit. Po kështu, Institucioni ka ndërtuar edhe mekanizma të ndryshëm funksionalë për të siguruar përfshirjen e studentëve në aktivitete të ndryshme shkencore, jetën akademike universitare dhe sociale. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 5.3 Kuotat e pranimit MSH] [Evidenca 5.8 Aktivitete sportive UT 65 vjet]

	[Evidenca 5.11 2021-2022; Evidenca 5.11 2022-2023; Evidenca 5.11 2023-2024] [Evidenca 5.14 Alumni]
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Institucioni, çdo vit akademik, vendos kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimit "Master i Shkencave në Matematikë". Kjo bëhet me miratim të Senatit të UT dhe vendim të MASR. GVJ konstaton procedurën e ndjekur dhe faktin që të gjitha kriteret e pranimit publikohen në faqen zyrtare të UT, FSHN dhe Departamentit të Matematikës. [Evidenca 5.3 Kuotat e pranimit MSH] [Evidenca 5.11 2021-2022; Evidenca 5.11 2022-2023; Evidenca 5.11 2023-2024]
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ konfirmon faktin se kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve në programin e studimit "Master i Shkencave në Matematikë", kriteret e përparimit gjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit mund të aksesohen lehtësisht nga publiku, si në formë print ashtu edhe në formatin online. FSHN/DM/UT kanë ngritur mekanizmat që e bëjnë të mundur këtë gjë: zyra e "Degës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës", website-i i FSHN, broshura "Guida e Studentit" etj. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Matematikës] [Evidenca 1.11 Guida e FSHN]
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ, nëpërmjet takimeve në institucion dhe dokumentacionit në dispozicion, konstaton se Departamenti i Matematikës, që që në dhjetor të vitit akademik të mëparshëm, informon të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programeve të studimit. Ky informim është i detajuar dhe i aksesueshëm për të gjithë, duke siguruar që kandidatët të kenë njohuri të plota rreth kushteve dhe kërkesave të programit përkatës. Ky proces mundëson një pranimin dhe planifikim të qartë, të bazuar në informata të sakta për të gjitha palët e interesuara. [Evidenca 5.24 Kriteret e pranimit në MSc+mbledhje]
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ vëren se Departamenti i Matematikës ka në vëmendje edhe aspektet sociale dhe ekonomike të profilin të studentëve kandidate për këtë Master. Kjo nënkupton faktin që miratohen kuota të veçanta për studentët me aftësi të ndryshme, pakicat kombëtare apo shtresat në nevojë. Numri i tyre është në përpjesëtim me përfaqësimin e tyre në shoqëri dhe numrin e kuotave totale të parashikuara. [Evidenca 5.3 Kuotat e pranimit MSH]

	[Evidenca 5.11 2021-2022; Evidenca 5.11 2022-2023; Evidenca 5.11 2023-2024]			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ konstaton se Programi i nivelit Master i Shkencave në Matematikë ofrohet vetëm në gjuhën shqipe. Në këtë mënyrë, ky program nuk është i aksesueshëm për studentë jo-shqipfolës nga shtete të ndryshme. Duke marrë parasysh proceset shoqërore të zhvillimit evropian dhe botëror, edhe në fushën e Arsimit të Lartë dhe teknologjisë, <i>GVJ rekomandon që të vendoset si prioritet nga Departamenti i Matematikës/FSHN/UT mundësia e aksesimit të këtij programi edhe në gjuhë të tjera (p.sh. anglisht).</i> Kjo do të sigurojë rritjen e numrit të studentëve (që, siç dihet, është një faktor kritik edhe për shkencat e matematikës), dhe do të mundësonte përfshirjen e praktikave pozitive europiane dhe më gjerë në fushën e Arsimit të Lartë Shqiptar. [Evidenca 5.3 Kuotat e pranimit MSH]			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/ bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Nga takimet e kryera dhe shqyrtimi i dokumentacionit zyrtar, GVJ konstaton se Institucioni ka një politikë përkrahëse sociale për shtresat në nevojë, duke ofruar bursa në nivele të caktuara. Gjithashtu, këto politika përkrahëse nuk mungojnë edhe për studentët me rezultate të larta, duke ndikuar kështu në rritjen e performancës së diplomës. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 5.12 Lista e st burse 21-22; Evidenca 5.12 Lista e st me burse 2023-2024; Evidenca 5.12 Lista e studenteve me burse 2021-2022.; Evidenca 5.12 Lista e st me burse 2023-2024]			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se Departamenti i Matematikës/FSHN/UT ka një sistem të mirëstrukturuar dhe të qartë për pranimin e studentëve në diplomën e nivelit Master i Shkencave në Matematikë, duke përfshirë politika dhe kriteret të përcaktuara për kategoritë e ndryshme të kandidatëve, përfshirë ata me aftësi të veçanta dhe ata nga shtresat në nevojë. Institucioni publikon dhe komunikon me transparencë kriteret dhe procedurat sipas akteve rregulluese në fuqi, duke garantuar mundësi të barabarta për të gjithë studentët potencialë. Departamenti duhet të ketë në vëmendje faktin që ky program studimi të mund të jetë i aksesueshëm edhe për studentët jo shqipfolës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ konstaton se, duke u njohur me rregulloren e programit të studimit në Masterin Shkencor të Matematikës, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, si dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës, studentët e marrin këtë informacion në shumë forma: elektronike, nëpërmjet website-ve, si dhe nga pedagogu përgjegjës për këtë program. Vetë Institucioni/ Departamenti i Matematikës vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion është i aksesueshëm për studentët dhe për të interesuarit, gjë që mundëson një proces transparent dhe të drejtë për të gjithë studentët. [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 3.47 Rregullore e Diplomimit]
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstaton se Departamenti i Matematikës kryen procedurën e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo të studimeve të pjesshme nëpërmjet Komisionit të Ekuivalentimeve dhe Transferimeve, i cili funksionon në përputhje me Statutin e UT. Procedura është transparente dhe e aksesueshme për të interesuarit. [Evidenca 5.1 Transferim Studimesh] [Evidenca 5.2 Miratim komisioni ad-hoc për deget e dyta dhe transferimet]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstaton se informimi në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit është i përcaktuar në Rregulloren e Programit të Studimit. Gjithashtu, në syllabuset e moduleve përcaktohen elementët e veçantë të vlerësimit të njohurive, mënyra e pikëzimit dhe konvertimi në notë. Studentëve iu bëhet me dije nga pedagogu përgjegjës për modulin që në ditën e parë të mësimit. [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit]
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se studentët informohen në lidhje me kriteret dhe procedurat për punimin e diplomës dhe diplomimin në programin e studimit nga kujdestarët akademikë, pedagogët udhëheqës, si edhe nga sekretaria mësimore, të cilat janë të pasqyruara në rregulloret përkatëse të studimit. [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 3.47 Rregullore e Diplomimit]
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të	GVJ konstaton se Departamenti i Matematikës, si autoriteti përgjegjës për këtë diplomë të nivelit Master, çdo fillim viti i vë studentëve në dispozicion informacionin për programin e studimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të shkollës, fletëve informuese, sekretarisë, degës së brendshme të sigurimit të cilësisë dhe karrierës, stafit akademik dhe përgjegjësit të programit. Po ashtu, përdoret edhe platforma online e informimit.

ardhshëm mbi programin e studimit.	[Evidenca 1.11 Guida e FSHN] [Evidenca 5.14 Alumni] [Evidenca 5.21 Keshillim Karriere]			
Konkluzione	GVJ vëren se Departamenti i Matematikes/FSHN/UT ka një proces të qartë dhe të hapur për informimin e studentëve dhe të interesuarve në lidhje me kriteret dhe procedurat e ndryshme akademike që duhet të ndjekin për diplomën “Master i Shkencave në Matematikë”. Baza ligjore që ndiqet, si dhe procedurat, sigurojnë barazi dhe gjithëpërfshirje për studentët kandidatë të interesuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se studentët janë të informuar në detaje për strukturën dhe organizimin e procesit mësimor, orët e teorisë dhe praktikës, si dhe periodat e provimeve dhe diplomimit, përmes kalendarit akademik të ofruar nga Përgjegjësi i programit dhe personat e ngarkuar nga Departamenti. Në lidhje me planin mësimor, lëndët dhe modulet, studentëve u ofrohet informacion edhe në auditorët e leksioneve. Ky informacion është gjithashtu i disponueshëm në formatin online, në web-in e FSHN. [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konstaton se Departamenti i Matematikes siguron informacionin e duhur për studentët e interesuar në lidhje me dokumentacionin e programit të studimit “Master i Shkencave në Matematikë”. Ky informacion është i aksesueshëm për të gjithë, duke përfshirë edhe formatin online. [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 1.12 Strategjia e Kombetare e Arsimit] [Evidenca 2.5 Plani mësimor, Diplomë e studimeve të Ciklit II(DND) në Matematikë 2008-2009]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Departamenti i Matematikes/FSHN/UT ofron informacion të plotë për mundësitë e punësimit dhe siguron mbështetje të vazhdueshme për orientimin e studentëve drejt tregut të punës përmes zyrës “Dega e Sigurimit të Cilësisë dhe Karrierës”, e ngritur specifikisht për këtë qëllim. Kjo zyrë është e angazhuar në zhvillimin e aktiviteteve edukative dhe profesionale, duke mbajtur kontakte të rregullta me studentët dhe të diplomuarit për të ndjekur dhe mbështetur zhvillimin e karrierës së tyre.

	Një formë tjetër janë edhe panairot e punës të organizuara nga Universiteti. [Evidenca 5.16 Studimi i Tregut të Punës UT FSHN] [Evidenca 5.17 Studimi i Tregut të punës DM] [Evidenca 5.21 Keshillim Karriere] [Evidenca 5.25 Career Planning]			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Departamenti i Matematikës ofron informacion të detajuar për zhvillimin e procesit mësimor, duke përfshirë oraret e ligjëratave, praktikant dhe aktivitete të tjera akademike. Ky informacion është i disponueshëm përmes platformave online (faqes elektronike të fakultetit) dhe gjithashtu i shpërndarë nëpërmjet tabelave informuese në vende të dukshme dhe të aksesueshme nga studentët. Po ashtu, studentët kanë akses në informacion për logjistikën e procesit mësimor, infrastrukturën, si bibliotekat, laboratorët dhe pajisjet teknologjike. [Evidenca 2.3 Syllabuset shqip dhe anglisht] [Evidenca 4.25 Foto të stendes së DM] [evidenca 4.29 Informacion portal e-student 1] [evidenca 5.4 Llogaritë në sistem të studentëve]			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ konstaton se FSHN, pra edhe Departamenti i Matematikës, menaxhon platformat online për informimin e studentëve rreth aktiviteteve që organizohen, si edhe për çdo njoftim apo informacion tjetër që u nevojitet studentëve. Po kështu, studentët kanë mundësi të marrin informacione të personalizuar dhe të aksesojnë të dhënat personale mbi avancimin e tyre akademik nëpërmjet portalit online e-student. [Evidenca 3.16 Komunikim në Teams me studentet] [Evidenca 3.17 Ngarkime materiale në Teams] [Evidenca 3.18 Komunikimi në email me studentet]			
Konkluzione	GVJ vëren se Departamenti i Matematikës/FSHN/UT ka një sistem të efikas për informimin e studentëve mbi mundësitë e ofruara gjatë procesit mësimor dhe mbështetje të vazhdueshme për orientimin drejt tregut të punës. Institucioni siguron informacion të plotë dhe të përditësuar për lëndët, modulet, aktivitetet formuese dhe mundësitë e zhvillimit profesional, duke ofruar udhëzues të detajuar dhe platforma online të aksesueshme për studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni, bazuar në legjislacionin përkatës, siguron mbajtjen dhe përditësimin e statistikave vjetore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në çdo program studimi. Këto të dhëna përfshijnë informacion të detajuar mbi pranimin e studentëve, arritjen e përfundimit të studimeve dhe diplomimin. Statistikat janë të organizuara dhe të aksesueshme për analizë të brendshme dhe ofrohen në mënyrë transparente për palët e interesuara. Përgjegjëse për këtë është sekretaria mësimore e programit të studimit dhe kryesekretaria e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, e cila menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Përmes këtyre të dhënave, institucioni monitoron dhe vlerëson ecurinë e programeve akademike dhe i siguron autoriteteve përkatëse informacion të rëndësishëm për planifikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të politikave akademike. [Evidenca 3.36 Regjistri themeltar të studentëve] [Evidenca 3.37 Regjistri i arritjeve akademike] [Evidenca 3.38 Sekretaria Mesimore]
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ, pas takimeve në Institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton se statistikave vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit për çdo program studimi, menaxhohen nga Sekretaria Mësimore e këtij fakulteti (FSHN). Këto të dhëna ruhen në formë të shkruar dhe në formë elektronike, sipas mënyrës së përcaktuar nga MAS. [Evidenca 3.38 Sekretaria Mesimore] [Evidenca 5.26 Procesverbal Notash provimi(model nga portali)] [Evidenca 5.27 Cregjistrim i studenteve]
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga hulumtimet e kryera nga GVJ, konstatohet se në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave, informacioni mund të futet dhe modifikohet vetëm nga persona të autorizuar, në përputhje me detyrat e tyre (sekretaria mesimore, dega mësimore e FSHN). Kohët e fundit është kryer edhe dixhitalizimi i procedurave të Sekretarive Mesimore në rang Universiteti, çka ka sjellë një përmirësim të shërbimit dhe aksesimit të të dhënave nga palët e interesuara, në përputhje me legjislacionin përkatës. GVJ rekomandon vazhdimin e procesit të mëtejshëm të dixhitalizimit të funksionimit të sekretarive mesimore, për të siguruar lehtësira të shtuar në aksesimin e të dhënave për palët e interesuara. [Evidenca 3.36 Regjistri themeltar të studentëve] [Evidenca 3.37 Regjistri i arritjeve akademike] [Evidenca 3.38 Sekretaria Mesimore] [Evidenca 4.28 Rregullore për funksionimin e sistemit informatik në Universitetin e Tiranës]
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse	Sipas informacioneve të disponueshme, sekretaria mesimore e FSHN monitorohet nga Dekanati i FSHN, duke përfshirë kontrollin e plotësisht të secilit regjistrë, verifikimin e saktësisë së të dhënave duke i krahasuar

për menaxhimin (sekretaritë mesimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	informacionet në sistemin elektronik me ato në formatin shkresor në fund të vitit akademik, si dhe zgjidhjen e problematikave të veçanta. Gjatë kryerjes së këtyre detyrave, personeli i sekretarisë konsultohet, orientohet, monitorohet dhe kontrollon nga Zëvendës-Dekani për anën mesimore i FSHN. [Evidenca 1.1 Statuti i UT.] [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 3.38 Sekretaria Mesimore] [Evidenca 6.4 Rregullore DSBCK]			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Nga verifikimet e bëra rezulton se Njësia bazë, që në këtë rast është Departamenti i Matematikës, harton raporte vlerësimi si pjesë e raportit të njësive kryesore dhe, përmes saj, të raportit institucional të UT. Në analizat vjetore që kryen, Departamenti paraqet rezultate analitike mbi numrin e të regjistruarve dhe të diplomuarve në programin e studimit "Master i Shkencave në Matematikë".GVJ rekomandon që Departamenti, si njësia bazë dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me studentët e diplomës "Master i Shkencave në Matematikë", të kryejë analiza më të shpeshta sasiore dhe cilësore mbi ecurinë e programit. Kjo do të ndihmonte në kuptimin më të mirë të problemeve me të cilat përballen fushat e tilla studimi. [Evidenca 3.24 Raport mbi analizen vjetore të Departamentit të Matematikës 2021-2022] [Evidenca 3.25 Raportet 22-23] [Evidenca 3.26 Shkresa e Raporti vjetor 2022-2023] [Evidenca 3.27 RAPORTI VJETOR FSHN UT 2023-2024]			
Konkluzione	GVJ vëren se Institucioni ka një sistem të mirëorganizuar dhe efikas për mbledhjen, menaxhimin dhe përditësimin e informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetet e tyre akademike. Nëpërmjet kontrollit periodik dhe raporteve analitike vjetore, sigurohet që të dhënat mbi profilin e studentëve, cilësinë e punësimit dhe rezultatet akademike janë të sakta dhe të disponueshme për analizë. Institucioni përdor gjithashtu një qasje transparente për të monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e programit, duke mbështetur zhvillimin akademik të studentëve dhe orientimin e tyre drejt tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Sipas dokumentacionit të disponueshëm dhe takimeve të zhvilluara në Institucion, GVJ konstaton se UT parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, në përputhje me akte ligjore dhe rregullore të institucionit. Angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse të UT është parashikuar në Statutin e UT, ku studentët kanë përfaqësuesit e tyre në katër komisione, duke përfshirë edhe studentët e Masterit të Shkencave në Matematikë. Po ashtu, studentët kanë në dispozicion këshillat studentore përkatëse. [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 3.22 Komisionet ne UT] [Evidenca 5.20 Komisioni zgjedhor]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Neni 47 i Statutit të UT, “Të drejtat e studentëve”, garanton të drejtën e studentëve për të përfaqësuar veten në vendimmarrje, këshillime dhe vlerësim në procesin akademik. Po ashtu, studentët përfaqësohen si pjesë e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm (GVB), të cilat kanë për detyrë vlerësimin e performancës akademike të një programi mësimor. Një formë tjetër përfshin edhe organizimin e pyetësorëve nga Departamenti i Matematikës. GVJ vlerëson se studentët janë të përfaqësuar në mënyrë efektive në vlerësimin e procesit akademik. [Dokumenti 1: VENDIMI PER GVB.] [Evidenca 5.13 Grupet e Punës për Vetevlerësimin Institucional në UT] [Evidenca 6.4 Rregullore DSBCK]
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Sugjerimet dhe kontributi i studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit merret edhe në nivel departamenti, nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve dhe analizimit të raporteve në lidhje me këta pyetësorë. Po kështu, përfaqësimi i studenteve në komisione të përhershme siguron përfshirjen e studenteve në këtë proces. Departamenti i Matematikës nëpërmjet analizave vjetore dhe rishikimit të programit të studimit shprehet se merr në konsideratë vërejtjet apo gjetjet e pyetësorëve të organizuar me studentet e këtij masteri. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 6.11; 6.12; 6.13 Raport “Vlerësimi i studenteve që diplomohen] [Evidenca 6.15 Raport vjetor për vlerësimin e cilësive të programeve] [Evidenca 6.15.1 Përcjellje e pyetësorëve] [Evidenca 6.16 Plani i Masave+Shkrese përcjellese]
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë	GVJ konstaton se, në aspektin ligjor, studentëve u mundësohet të shprehin mendimin mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit dhe rishikimit, bazuar në nenet 61 dhe 62 të Rregullores së Universitetit të Tiranës, si dhe në Rregulloren e Programit të Studimeve

mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	të Masterit të Shkencave në Matematikë. Edhe në Departamentin e Matematikës ekziston një procedurë e saktësuar mbi procesin e ankimimit apo rivlerësimit të njohurive të studentëve, e cila ndjek hierarkinë: Dekan – Përgjegjës Departamenti – Pedagogu i lëndës ose Përgjegjësi i Departamentit – Komision Ad hoc. [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit] [Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Matematikës]			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Institucioni ka krijuar një sistem ku studentët janë të përfshirë aktivisht në proceset vendimmarrëse dhe përmirësuese të programeve akademike, duke siguruar mundësi për të kontribuar në mënyrë konkrete dhe frutdhënëse. Po kështu, ata kanë mundësinë të japin mendimin e tyre lidhur me procesin e vlerësimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ kërkoi informacione më të detajuara në lidhje me procedurat dhe strukturën përgjegjëse për informimin e studentëve dhe shërbimet e ofruara për ta, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Përgjegjësi i Departamentit të Matematikës dhe aktorë të tjerë të shërbimit ofruan informacion të detajuar mbi kërkesën tonë. Procedurat janë të përcaktuara nëpërmjet akteve nenligjore të UT, ndërsa disa njësi të posaçme janë krijuar për informimin dhe mbështetjen e studentëve. Informacionet bazë për studentët janë të disponueshme edhe në faqen zyrtare të institucionit (FSHN), e cila përditësohet rregullisht. Po ashtu, zyrat përkatëse brenda institucionit informojnë vazhdimisht studentët dhe ofrojnë shërbimet e kërkuara prej tyre. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 1.3 Rregullore e UT] [Evidenca 1.10 Rregullore e Programi i Studimit]
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që	GVJ konstaton se në FSHN/UT ekziston dhe funksionon një sistem i posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre në çështjet që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit Master i Shkencave në Matematikë. Të gjitha informacionet për studentët janë të hapura, ndërsa udhëzimet e ofruara gjatë gjithë kohës individualisht e bëjnë të qartë kuptimin e rregulloreve

kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	dhe direktivave të shkruara, të cilat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme për studentët. Në funksion të kësaj, Departamenti i Matematikës ofron edhe kujdestarin akademik për studentët e këtij programi studimi. [Evidenca 2.15 Lista e kujdestareve per studentet e cdo viti Programit Master Shkencor ne Matematik]			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	GVJ konstaton se në FSHN funksionon Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, e cila, në bashkëpunim edhe me Departamentin e Matematikës, informon dhe mbështet studentët gjatë gjithë periudhës së tyre të studimeve. Një nga qëllimet kryesore të kësaj dege është ndërveprimi i drejtpërdrejtë me studentët, me qëllim njohjen e tyre me përmbushjen e procesit mësimor dhe orientimin drejt tregut të punës. Kjo degë e ushtron veprimtarinë e saj mbi baza të qarta ligjore dhe administrative. [Evidenca 6.25 Vendim Nr. 51 i Senatit Akademik 23.12.2020 Për miratimin e Paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT] [Evidenca 6.26 Manuali i Cilësisë] [Evidenca 6.34.1 Rregulore për Organizimin dhe Funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UT] [Evidenca 6.35 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT]			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në FSHN, funksionon edhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës. Kjo zyrë, në bashkëpunim edhe me Departamentin e Matematikës, gjurmon ecurinë e studentëve që diplomohen në këtë program studimi (dhe jo vetëm) në tregun e punës me anë të pyetësorëve online, pasi ata përfundojnë studimet dhe diplomohen. Të dhënat e gjeneruara nga pyetësori përdoren për të kryer studime mbi zhvillimin e karrierës së studentëve në tregun e punës. Ky është një informacion me vlerë për Departamentin dhe Institucionin, sepse shërben për të hartuar apo përmirësuar politikat e zhvillimit të programeve të studimit dhe jo vetëm.[Evidenca 6.34.1 Rregulore për Organizimin dhe Funksionimin e Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UT]			
Konkluzione	GVJ konstaton se Institucioni ka krijuar një sistem të strukturuar për informimin, këshillimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve, duke siguruar që ata të kenë mbështetje të vazhdueshme për çdo çështje që lidhet me procesin mësimor dhe programin e studimit. Po kështu, Institucioni ka mekanizmat e vet funksionale për të ndjekur në perspektivë ecurinë e studentëve në tregun e punës dhe ta përdorë këtë informacion për politikat e veta akademike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Referuar dokumentacionit të disponueshëm si dhe takimeve në Institucion, GVJ konstaton se Institucioni kryesor, që në këtë rast është Universiteti i Tiranës, garanton të drejtën e njërive bazë për organizimin e veprimtarisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe inovacionit nëpërmjet dokumentave të ndryshëm zyrtarë. UT/FSHN/Departamenti i Matematikës ka hartuar strategjinë e zhvillimit të detajuar në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të cilat janë të përshtatura për lëndët dhe modulet specifike të programit të studimit në fjalë. Aktet rregullatore institucionale ofrojnë gjithashtu orientime të qarta për pedagogët mbi mënyrat e ndryshme të mësimdhënies, përfshirë metodat tradicionale dhe ato më moderne. Përdorimi i metodave inovative ka për qëllim rritjen e angazhimit të studentëve dhe përmirësimin e rezultateve të tyre, duke i mundësuar atyre të përvetësojnë njohuri në mënyrë më të efektshme dhe të zhvillojnë aftësi praktike dhe kritike. Kjo qasje e strukturuar kontribuon në përmirësimin e cilësisë akademike dhe ofron mundësi të reja për zhvillimin e studentëve në fushat e studimeve të tyre. Departamenti i Matematikës ka punuar për ngritjen e infrastrukturës përkatëse mbështetëse në këtë drejtim. [Evidenca 3.11 Strategjia Institucionale për mësimdhënies, Universiteti i Tiranës 2022-2027] [Evidenca 3.3 Manual për përdorimin e platformës Microsoft Teams] [Evidenca 4.11 Foto te laboratorit te Matematikës]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Në UT, funksionon Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë nëpërmjet Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) që në nivel institucioni bashkëpunon dhe bashkërendon punën me Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel njësie kryesore dhe bazë (FSHN/DM) që është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Staf i akademik i Departamentit të Matematikës është pjesë përbërëse e këtyre mekanizmave të monitorimit për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative. Gjithashtu, pranë UT funksionojnë edhe komisione të ndryshme për këtë qëllim. UT ka vënë në funksionim manualin e Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik, i cili përcakton mënyrën dhe metodën e vlerësimit të personelit akademik të Universitetit të Tiranës, për të gjitha kategoritë. Vlerësimi i cilësisë së veprimtarisë mësimore zhvillohet gjatë gjithë vitit nëpërmjet formave të ndryshme të dokumentuara. [Evidenca 1.1 Statuti i UT]

	[Evidenca 1.5 Plani i zhvillimit strategjik te programit te studimit Msc ne Matematike] [Evidenca 5.13 Grupet e Punës për Vetevlerësimin Institucional në UT] [Evidenca 6.22 Vendim Nr. 30, datë 22.07.2021 i Senatit Akademik (Per miratimin e manualit të vlerësimit të performancës së personelit akademik te UT)] [Evidenca 6.23 Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të Universitetit të Tiranës]
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	E drejta e studentëve për përfshirje në vlerësimin periodik të aktivitetit akademik, mësimdhënës dhe jo vetëm, shprehet me anë të organizimit në fund të semestrit dhe në mënyrë periodike, të plotësimit të pyetësorëve për vlerësimin e pedagogëve dhe të programit të lëndëve. Kjo gjë bëhet nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës. Rezultatet e pyetësorit analizohen dhe vlerësohen me qëllim përmirësimin e indikatorëve dhe treguesve të cilësisë akademike në institucion. Pas analizës, përgatitet raporti përfundimtar, i cili përfshin rekomandime dhe masat përkatëse për përmirësimin e procesit mësimor dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve akademike. [Evidenca 6.3.1 Vlerësimit i lëndës nga studenti_Sem I _va 2021-2022] [Evidenca 6.8; 6.9; Raport për pyetsorin “Raport i Studentëve”, 2021-2022 FSHN UT] [Evidenca 6.11; 6.12 Vleresim i studenteve qe diplomohen] [Evidenca 6.13; 6.14; 6.15 Raport vjetor per vleresimin e cilesise se programeve 2023-2024] [Evidenca 6.15.1 Percjellje e pyetsoreve.] [Evidenca 6.15.2 Percjellje e raporteve(e_mail) të hartuara nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës 2022.] [Evidenca 6.16 Plani i Masave+Shkrese percjellese]
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Referuar formatit të pyetësorit, pyetësori për vlerësimin e pedagogëve dhe të lëndës është një nga elementët kyç që përdoret për të monitoruar cilësinë e mësimdhënies. Ky pyetësor për studentët përmban një analizë me gjetjet dhe konstatimet lidhur me performancën e pedagogëve dhe përmbajtjen e lëndëve. GVJ konstaton se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës publikon në mënyrë periodike raportin e analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Kjo gjë bëhet konform legjislacionit përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale. [Evidenca 6.18 Raport vjetor DSBCK 2]
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për	Departamenti i Matematikës, si pjesë integrale e FSHN/UT, promovon shembuj të praktikave më të mira dhe inkurajon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien, duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, mbështetje financiare për pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare apo botime të këtij lloji. Gjithashtu, institucioni

përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare ku realizohen mobilitete të stafit përmes projekteve të Erasmus+. Këto iniciativa synojnë rritjen e cilësisë akademike, zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale dhe shkëmbimin e përvojave me institucione të tjera arsimore ndërkombëtare. GVJ vëren se, në dokumentacionin e disponuar si dhe në raportin e GVB, nuk trajtohet problemi se çfarë procedurash ndiqen në rast të evidentimit të performancës së dobët akademike për një staf akademik apo zëvendës akademik; si trajtohet ky rast nga strukturat përkatëse. GVJ rekomandon që Departamenti duhet të trajtojë gjetjet e opinioneve të studentëve në lidhje me performancën akademike, pas çdo semestri (pas rezultateve të pyetësorëve semestralë), jo vetëm gjatë analizës vjetore, e cila zakonisht bëhet në mbyllje të vitit akademik. GVJ konstaton se mbështetja financiare nga ana e institucionit është e ulët, duke pasur parasysh faktin që pedagogët e këtij programi kanë vështirësi objektive në burime të tjera financimi (ekspertiza ndaj palëve të treta, etj.). Rekomandohet që të rritet kjo mbështetje. Gjithashtu rekomandojmë të rriten përpjekjet për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare dhe kombëtare, si një element i rëndësishëm integruar, promovues dhe zhvillues për stafet akademike dhe të tjerë. [Evidenca 3.24; 3.25; 3.26 Raport mbi analizen vjetore të Departamentit të Matematikës 2021-2022] [Evidenca 2.27 Cmimi shkencor Pilika për punimin e doktoratës me të mirë] [Evidenca 2.28 Lista e mobiliteteve dhe pjesëmarrje në cost] [Evidenca 3.15 Trajnimet “online” për personelin akademik] [Evidenca 3.27 RAPORTI VJETOR FSHN UT 2023-2024]			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka një sistem të strukturuar dhe të qartë për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së stafit akademik, i cili përfshin përdorimin e formatit të pyetësorëve për vlerësimin. Institucioni siguron mundësi të vazhdueshme trajnimi dhe zhvillimi profesional për stafin akademik dhe mbështet mobilitetin ndërkombëtar përmes bashkëpunimeve dhe projekteve të Erasmus+.</i> <i>Rekomandojmë që të rritet mbështetja financiare nga ana e institucionit për stafin e këtij programi studimi, çka do të bënte të mundur rritjen e performancës akademike të punës së tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ vëren se Universiteti i Tiranës, pjesë e të cilit është FSHN dhe Departamenti i Matematikës me programin përkatës, ka ngritur dhe ndjek politika, struktura dhe procedura të qarta për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë nëpërmjet Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), ose Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel njësie kryesore, në përputhje të plotë me bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me aktet rregullatore institucionale. Kjo siguron që cilësia e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të mbështetura akademike të monitorohet dhe vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të strukturuar. Përmes këtij sistemi, institucioni implementon dhe përmirëson procedurat e menaxhimit të cilësisë në çdo nivel, duke përfshirë vlerësimin e performancës së pedagogëve, proceset e studimit dhe ofrimin e shërbimeve të tjera për studentët. Ky mekanizëm i sigurisë së cilësisë është i projektuar për të mbështetur zhvillimin e vazhdueshëm të institucionit akademik dhe për të garantuar përmbushjen e standardeve të larta të arsimit. [Evidenca 1.1 Statuti i UT [Evidenca 6.2 Hapja e zyres DSBCK] [Evidenca 6.34 Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë KPSSC në UT] [Evidenca 6.34.1 Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e Njësisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UT] [Evidenca 6.35 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT] [Evidenca 6.18 Raport vjetor DSBCK]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	GVJ vëren se Institucioni (UT) ka ngritur dhe mban në funksionim një Sistëm të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, i cili siguron një strukturë të organizuar dhe efikase për menaxhimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike. Ndërsa Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN), si njësi kryesore, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Njësie Kryesore dhe Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK). Këto janë struktura përgjegjëse të autorizuar nga Senati Akademik për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Ajo përbëhet nga anëtarë personel akademik dhe anëtarë studentë. [Evidenca 3.22 Komisionet UT] [Evidenca 6.2 Hapja e zyres DSBCK]
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të	GVJ vëren se UT (ku bën pjesë FSHN si njësi kryesore dhe Departamenti i Matematikës, si njësi bazë me programin e Masterit të Shkencave në Matematikë) përdor procese të rregullta të vlerësimit të jashtëm, përfshirë akreditimin e programeve të studimit, si dhe vlerësime analitike e krahasuese që i mundësojnë atij të monitorojë dhe përmirësojë cilësinë e ofruar. Ky proces siguron që të gjitha programet akademike të

jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	përbushin standardet e kërkuara dhe të jenë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Përveç vlerësimit të jashtëm, institucioni angazhon gjithashtu procese të brendshme që fokusohen në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të cilësisë, duke përfshirë vlerësimin e performancës së pedagogëve dhe të studentëve nëpërmjet strukturave përkatëse. Kjo qasje e shumëfishtë promovon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe siguron që programet e studimit të jenë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. [Evidenca 2.14 Çertifikata e akreditimit për programin Bachelor në Matematik, FSHN, UT] [Evidenca 6.28 Paketa e instrumenteve të cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)]
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ vëren se Institucioni përdor tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim shkencor për të pasqyruar gjendjen aktuale, arritjet dhe dobësitë në këto fusha. Këta tregues janë të integruar në aktet rregullatore të institucionit dhe shërbejnë si një mjet për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit. Nëpërmjet përdorimit të këtyre treguesve, institucioni është në gjendje të identifikojë arritjet dhe dobësitë e shfaqura. Gjithashtu, institucioni përdor këta tregues cilësorë për të nxitur dhe promovuar arritjet më të mira, duke ofruar mundësi avancimi për studentët dhe stafin akademik që kanë kontribuar në arritjen e rezultateve të shkëlqyera. GVJ mendon se kjo politikë stimulon një kulturë përmirësimi dhe motivon të gjithë faktorët e përfshirë në këtë proces. GVJ konstaton se mbështetja promovuese (financime studimi apo kërkimi shkencor) e Fakultetit apo Departamentit kundrejt stafit akademik dhe studentëve të programit Master i Shkencave në Matematikë është në nivele të ulëta. [Evidenca 6.3 Njoftim për plotësimin e formularit të vlerësimit] [[Evidenca 6.3.1 Vlerësimit i lëndës nga studenti] [Evidenca 6.15.1 Përcjellje e pyetsoreve] [Evidenca 6.18 Raport vjetor DSBC] [Evidenca 3.7 Projekt i financuar nga FSHN] [Evidenca 3.9 Projekti PKKZH] [Evidenca 3.10 Projekti PIKSH]
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se Institucioni ka vënë në funksionim një sistem efikas për përdorimin e treguesve të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, të cilët ndihmojnë në pasqyrimin e gjendjes aktuale dhe identifikimin e arritjeve dhe dobësive. Përmes treguesve cilësorë, institucioni është në gjendje të nxisë arritjet më të mira, duke motivuar studentët dhe stafin akademik për të arritur nivele të larta të performancës dhe duke siguruar një mjedis të qëndrueshëm për zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm në programet e studimit. GVJ rekomandon rritjen e mbështetjes (kryesisht financiare) nga ana e</i>

	<i>Institucionit për promovimin e stafit akademik dhe studentëve me rezultate të larta në këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ konstaton se, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, ku bën pjesë edhe Departamenti i Matematikës me programin e studimit të ciklit të dytë, në nivel Njësie Kryesore, për të siguruar dhe garantuar sigurimin e cilësisë së programeve të studimit të ciklit të dytë, është ngritur Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës (DSBCK) dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo strukturë, në koordinim me aktorët e tjerë të Departamentit dhe Fakultetit, ka për qëllim të identifikojë arritjet dhe dobësitë e programit të studimit. Njëkohësisht, bëhet një planifikim për masat për përmirësim, duke siguruar që procesi të mbetet i qëndrueshëm dhe të rritet cilësia e programeve. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe vihen në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse për të mundësuar veprime të mëtejshme për përmirësimin dhe zhvillimin e programeve të studimit. [Evidenca 6.2 Hapja e zyres DSBCK] [Evidenca 6.4 Rregullore DSBCK] [Evidenca 6.18 Raport vjetor DSBCK]
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Njësia bazë ofruese e programit të studimit (Departamenti i Matematikës), së bashku me DSBCK, përdorin mekanizma të ndryshëm të vlerësimit të performancës së programit të studimit, duke marrë në konsideratë aktorët dhe faktorët përkatës, mbi bazën e të cilave ndërtojnë edhe raportet përkatëse të vlerësimit të programit. Këto raporte japin një analizë të dobësive të identifikuara dhe masat për adresimin e këtyre mangësive, duke përfshirë ristrukturimin e programeve, përmirësimin e standardeve akademike, dhe fuqizimin e infrastrukturës mësimore në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore, si dhe standardet dhe kriteret akademike. Këto vlerësime gjenden në sistemin online të Institucionit (FSHN). Në rastin e akreditimit, raporte të detajuara hartohen nga GVB dhe miratohen nga strukturat përkatëse për të siguruar që programet e studimit të qëndrojnë të përditësuara dhe të përputhura me kërkesat më të larta të cilësisë.

	[Evidenca 6.6 Statistika në nivel lëndësh për programet e studimit] [Evidenca 6.9 Raport “Vlerësim i studentëve që diplomohen] [Evidenca 6.8; 6.12 Raport për pyetsorin “Raport i Studentëve”] [Evidenca 6.13; 6.14; 6.15 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve 2023-2024] [Evidenca 6.15.2 Përcjellje e raporteve(e_mail) të hartuara nga Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës] [Evidenca 6.16 Plani i Masave+Shkrese përcjellese]
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimet paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ konstatoi që Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies, të hartimit dhe korrigjimit të provimeve, rishikimin e kurrikulës, etj. Këto metoda përfshijnë kontrolle të zhvillimit të procesit mësimor (leksione, seminare, laboratorë dhe provimet); analizat mësimore dhe shkencore për stafin, si dhe ndërtimin e raporteve përkatëse. Këto metoda përdoren periodikisht, dokumentohen përmes raporteve dhe iu dërgohen autoriteteve drejtuese. Megjithatë, nuk janë vërejtur raste të vlerësimit paralel të provimeve. [Evidenca 1.4 Rregullore e Departamentit të Matematikës] [Evidenca 3.20 Detyre kursi] [Evidenca 6.1 Vlerësim performance në punë] [Evidenca 3.30 Model teze provimi] [Evidenca 3.39 Lista e temave të diplomave]
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve	GVJ konstaton se Institucioni përdor disa instrumente të tërthorta për të vlerësuar cilësinë e programit të studimit. Kështu, studentët e diplomuar japin vlerësimin dhe mendimin e tyre kritik për cilësinë e programeve të studimit nëpërmjet plotësimit të pyetësorit “Vlerësimi i studentëve që diplomohen” dhe “Raporti i Studentit”. Dega e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës organizon takime me ALUMNI të Departamentit të Matematikës. Departamenti përdor gjithashtu statistikën e punësimit dhe përgatit raporte mbi rezultatet e anketave, të cilat përpunohen dhe përdoren për vlerësimin dhe përmirësimin e mbarëvajtjes së programit. Në paketën e mekanizmave është parashikuar gjithashtu që në fund të çdo semestri të realizohet pyetësori "Raporti i vetëvlerësimit të lëndës nga pedagogu". Mekanizma vlerësimi ekzistojnë edhe për performancën e stafit ndihmës akademik të përfshirë në programin e Masterit të Shkencave në Matematikë. [Evidenca 5.14 Alumni] [Evidenca 5.17 Studimi i Tregut të Punës DM] [Evidenca 6.9; 6.10 Raport “Vlerësim i studentëve që diplomohen]

e kompetencave të përftuara nga ky program.	[Evidenca 6.20 Raporti i Gjurmimit]			
Konkluzione	GVJ konstaton se Institucioni ka ndërtuar një mekanizëm efikas të strukturuar për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, duke përdorur metoda dhe instrumente të tërthorta si sondazhe dhe intervista me studentë, ALUMNI dhe punëdhënës. Raportet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive miratohen përmes strukturave të vendimmarrjes të institucionit dhe janë të aksesueshme për të interesuarit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, vëren se Institucioni (DM/FSHN/UT) ka krijuar strukturat për zbatimin e procedurave të brendshme të cilësisë, ku përfshihen DSBCK, Departamenti i Matematikës dhe Fakulteti në të gjitha hallkat e sigurimit të cilësisë, duke siguruar përfshirjen në to të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Këto struktura janë të përcaktuara qartë në Statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL. Në përbërje të DSBCK ka aktorë që përfaqësojnë grupe të ndryshme interesi – pedagogë, përfaqësues të studentëve – me një synim të përbashkët: përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Po kështu, mbahen kontakte me studentët e diplomuar (ALUMNI) dhe kompanitë e punësimit të tyre. [Evidenca 3.22 Komisionet UT] [Evidenca 5.14 Alumni]
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Sipas dokumentacionit të dorëzuar dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se strukturat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë të përcaktuara qartë në Statut dhe aktet e tjera rregullatore të IAL, duke përfshirë edhe njësinë kryesore FSHN, pjesë e të cilës është njësi bazë, Departamenti i Matematikës. Këto akte rregullatore specifikojnë në mënyrë të detajuar mënyrën e krijimit të organeve përkatëse, funksionet kryesore të tyre, proceset e vendimmarrjes dhe ndërveprimin me njësitë e tjera të institucionit. GVJ vëren se detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për çdo njësi sigurojnë ushtrimin e duhur dhe me përgjegjësi të proceseve të sigurimit të cilësisë. [Evidenca 6.25 Vendim Nr. 51 i Senatit Akademik 23.12.2020 Për miratimin e Paketës së dokumentave për sigurimin e cilësisë në UT]

	[Evidenca 6.26 Manuali i Cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)] [Evidenca 6.27 Rregullore për sigurimin e cilësisë në UT (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)] [Evidenca 6.28 Paketa e instrumenteve të cilësisë (Miratuar nga Senati i Universitetit të Tiranës më 23.12.2020)] [Evidenca 6.29 b Vendim Nr. 12, i Senatit Akademik] [Tabela 24 – ASCAL]
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Sipas dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ vëren se në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit përfshihen në mënyrë aktive njësia bazë dhe ajo kryesore përgjegjëse për programin, si dhe të gjithë anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ. Po ashtu, studenti dhe përfaqësuesit e tij janë të përfshirë në vlerësimin e programit përmes pyetësorëve dhe diskutimeve të organizuara. Ky proces garanton një përfshirje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar, duke siguruar një vlerësim të plotë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit. [Evidenca 3.24; 3.25 Raport mbi analizen vjetore të Departamentit të Matematikës] [Evidenca 6.7; 6.8; 6.9 Raport “Vlerësim i studentëve që diplomohen”] [Evidenca 6.13; 6.14; 6.15 Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë së programeve]
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ konstaton se institucioni ka procedura dhe mekanizma të qartë që sigurojnë përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit, duke respektuar integritetin akademik. Ky parim ndiqet edhe nga DSBCK si strukturë e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Këto procese janë të strukturuar për të shmangur çdo lloj diskriminimi ose pabarazie kundrejt personelit akademik dhe studentëve. Dokumentacioni dhe praktikatat e vlerësimit janë të qarta dhe transparente, duke garantuar një trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë përfshirësit në proces. [Evidenca 3.21 Kodi i Etikës UT]
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vryera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ pati mundësinë të takojë me aktorë të ndryshëm të veprimtarisë akademike, përfshirë Dekanin e Fakultetit, Përgjegjësin e Departamentit të Matematikës, përfaqësues të stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe me grupin e vetëvlerësimit, përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës. Takimet konfirmuan një organizim të mirë të punës së përditshme, angazhim të plotë në procesin e akreditimit dhe një motivim të lartë për sigurimin e brendshëm të cilësisë. GVJ konstatoi gjithashtu se pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë ishin edhe bashkëpunëtorët e jashtëm. Kjo sigurohej nëpërmjet marrëveshjeve apo aktiviteteve të ndryshme ndër-institucionale. GVJ konstaton se në përbërje të kësaj strukture nuk ka anëtar të përherëshëm të jashtëm.

	[Evidenca 6.2.1 Vendim nr 129 i dekanatit FSHN] [Evidenca 1.8 Marreveshjet e FSHN] [Evidenca 1.9 Marreveshjet me UT]			
Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni ka arritur të krijojë një strukturë dhe proces efikas për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë të gjithë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në proceset e vlerësimit. Pjesëmarrja aktive e stafit akademik, studentëve dhe ekspertëve të jashtëm garanton një proces të drejtpërdrejtë dhe të integruar të vlerësimit, duke respektuar gjithashtu integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë është angazhuar në mënyrë aktive për trajtimin dhe zgjidhjen e sfidave që lindin gjatë mësimdhënies dhe auditimeve të ndryshme në strukturë. GVJ konstaton se politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaria e UT/FSHN janë transparente për personelin akademik dhe studentët dhe bëhen publike në faqen elektronike të UT/FSHN. [Evidenca 1.1 Statuti i UT] [Evidenca 6.8; 6.12 Raport për pyetsorin “Raport i Studentëve”] [Evidenca 6.9; 6.11 Raport “Vlerësimi i studentëve që diplomohen”] [Evidenca 6.18 Raport vjetor DSBCK]
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në bashkëpunim me drejtuesit e Departamentit apo fakultetit, organizon seanca informuese për studentët në lidhje me rëndësinë e rezultateve të vlerësimit të performancës akademike të pedagogëve dhe ndikimin e këtyre rezultateve në përmirësimin e programit të studimit. Institucioni siguron transparencë në publikimin e këtyre rezultateve, duke respektuar plotësisht lirinë akademike, etikën dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Raportet e vlerësimit gjenden online në web-in e FSHN. [Evidenca 6.2.1 Vendim nr 129 i dekanatit FSHN] [Evidenca 6.18 Raport vjetor DSBCK]
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë	Institucioni (në këtë rast DM/FSHN), në bashkëpunim me aktorët e interesuar, harton dhe implementon një plan masash për të adresuar mangësitë dhe dobësitë e evidentuara gjatë procesit të vlerësimit. Ky plan masash është i bazuar në rezultatet e vlerësimeve dhe synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, duke përfshirë

përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	ndërhyrje të nevojshme në aspektet e mësimdhënies, kurrikulës dhe mbështetjes për studentët. Kjo gjë siguron gjithashtu monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve të ndërmarra. [Evidenca 2.11 Titullaret e grupeve mesimore-kerkimore] [Evidenca 6.16 Plani i Masave+Shkrese percjellese]			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni siguron që monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë të kenë ndikim të matshëm në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Në këtë rast është DM/FSHN, që mund të ndërhijë në sistem nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm akademikë. Kjo arrihet përmes analizës së rezultateve të vlerësimeve dhe implementimit të masave korrigjuese, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përmbushjen e standardeve akademike. Institucioni ndjek me rigorozitet efektivitetin e këtyre veprimtarive, duke siguruar që përmirësimet të jenë të qëndrueshme dhe të dokumentuara për të garantuar progresin e vazhdueshëm. Në këtë proces merret në konsideratë edhe faktorët e jashtëm (grupet e interesit). [Evidenca 1.8 Marreveshjet e FSHN] [Evidenca 2.19 Kerkes dhe vendim për ndryshim mbi planet mesimore]			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se DM/FSHN organizon veprimtari periodike me stafin akademik (takime vjetore) dhe studentët për informimin dhe gjetjen e zgjidhjeve të problematikave të hasura në lidhje me programin e studimit në fjalë. Po kështu, organizohen takime me ALUMNI dhe faktorë të tjerë të jashtëm. Qëllimi është sigurimi dhe përmirësimi afatgjatë i cilësisë së programit të studimit. [Evidenca 3.5 Mbledhje departamenti mbi idete inovative kerkimore] [Evidenca 3.24 Raport mbi analizen vjetore të Departamentit të Matematikës 2021-2022] [Evideva 6.36 Mbledhje departamenti mbi përmirësimin e programit të studimit] [Evidenca 5.14 Alumni.]			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni ka krijuar mekanizma efektivë për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, duke angazhuar personelin dhe studentët, si dhe grupe interesi nga industria, në veprimtari periodike informimi dhe ndërgjegjësimi. Institucioni ka treguar angazhim të vazhdueshëm për rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e mëtejshëm të performancës akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Matematikë” ofruar nga Universiteti i Tiranës

Pikat e forta dhe afirmime

1. Qëndrueshmëria e personelit akademik efektiv. Kjo tregon stabilitetin e programit, besimin e institucionit ndaj tij dhe angazhimin e stafit në mbështetjen e studentëve.
2. Angazhimi i stafit akademik me kualifikime të larta dhe përvojë të konsoliduar profesionale. Prania e një stafi të tillë garanton zhvillimin e qëndrueshëm të orëve mësimore dhe rrit cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe të nxënies.
3. Programi ofron njohuri që u mundësojnë studentëve profilizim të përshtatshëm për vijimin e studimeve në nivel Doktorate, si dhe përputhje me kërkesat e tregut të punës.
4. Institucioni disponon njësi të posaçme funksionale për orientimin dhe këshillimin e studentëve, të cilat operojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe ofrojnë mbështetje gjatë gjithë ciklit të studimeve.

Pika të dobta

1. Mungesa e praktikës mësimore në kurrikulën e programit të studimit kufizon mundësinë e studentëve për të aplikuar njohuritë teorike në situata reale dhe për t'u përgatitur në përputhje me kërkesat e tregut të punës (*Standardi II/1*).
2. Pësia e lartë e provimit të diplomës, me vlerë 30 ECTS, përbën një shpërndarje të pabalancuar të krediteve dhe nuk është në përputhje me aktet rregullative në fuqi (*Standardi II/1*).

Rekomandime

1. Të realizohet një rishikim i shpërndarjes së krediteve në planin mësimor të programit të studimit, me qëllim që ngarkesa në kredite të provimit të diplomës të jetë në përputhje me kërkesat e legjislationit në fuqi. Ky rishikim duhet të sigurojë një balancë të drejtë mes komponentëve të ndryshëm të kurrikulës dhe të përfshijë në kurrikulën e programit të studimit një lëndë të dedikuar për praktikën profesionale.
2. Të sigurohet që numri i lëndëve të përcaktuara për personelin akademik efektiv të jetë në përputhje me kriteret ligjore të përcaktuara.
3. Të përditësohet literatura bazë, duke synuar shndërrimin e materialeve të leksioneve në tekste të mirëfillta universitare dhe përditësimin periodik të botimeve ekzistuese.
4. Institucioni duhet të parashikojë përdorimin e software-ve profesionale dhe të mjeteve antiplagjiaturë, si pjesë e infrastrukturës akademike, për të garantuar autenticitetin e punimeve studimore dhe kërkimore.

5. Është e nevojshme që programi i studimit dhe sekretaria mësimore të pajiset me një sistem elektronik më të avancuar, funksional dhe gjithëpërfshirës, i cili të mbështesë në mënyrë efikase menaxhimin e të dhënave akademike dhe administrative.
6. Rritjen e mbështetjes financiare për kërkimin shkencor të stafit akademik, pasi fondet aktuale janë të pamjaftueshme për të nxitur zhvillimin kërkimor dhe për të mbështetur publikimet shkencore me cilësi.
7. Të punohet për ofrimin e kurrikulës edhe në gjuhën angleze, duke e bërë programin më tërheqës për studentë të huaj dhe duke rritur ndërkombëtarizimin e institucionit.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Mathematics" provided by the Higher Education Institution "University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. Stability of the effective academic staff. This reflects the program's consistency, the institution's confidence in it, and the staff's commitment to supporting students.
2. Engagement of academic staff with high qualifications and consolidated professional experience. The presence of such staff ensures the sustainable development of teaching activities and enhances the overall quality of the teaching and learning process.
3. The program provides knowledge that enables students to develop an appropriate academic profile for continuing their studies at the doctoral level, as well as for aligning with labor market demands.
4. The institution has established dedicated functional units for student guidance and counseling, which operate continuously and provide support throughout the entire study cycle

Weaknesses

1. The absence of a teaching practice component in the study program curriculum limits students' opportunities to apply theoretical knowledge in real-life situations and to prepare in accordance with labor market requirements (*Standard II/1*).
2. The high weight of the Diploma Examination, amounting to 30 ECTS, represents an unbalanced distribution of credits and is not in compliance with the regulatory acts in force (*Standard II/1*).

Recommendation

1. A revision of the credit distribution within the study program curriculum should be carried out, to ensure that the credit load of the Diploma Examination complies with the requirements of the current legislation. This revision should provide a proper balance among the different curriculum components and include in the program a dedicated course on Professional Practice.
2. It should be ensured that the number of courses assigned to the effective academic staff is in accordance with the established legal criteria.
3. The core literature should be updated, aiming to transform lecture materials into fully developed university textbooks and to ensure the periodic updating of existing publications.
4. The institution should foresee the use of professional software and anti-plagiarism tools as part of the academic infrastructure, to guarantee the authenticity of students' academic and research work.

5. It is necessary for the study program and the teaching administration office to be equipped with a more advanced, functional, and comprehensive electronic system, which efficiently supports the management of academic and administrative data.
6. Increase financial support for the scientific research of academic staff since the current funds are insufficient to promote research development and to support high-quality scientific publications.
7. Efforts should be made to offer the curriculum also in English, to make the program more attractive to international students and to strengthen the institution's internationalization.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

